X — XI

[illegible] të mbizotroj
савладати
evails

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

MEMORENDUM ZYRTAR — **СЛУЖБЕНИ МЕМОРЕНДУМ**

Për/ За / To	**Të gjithë Deputetët e Kuvendit** **Све Посланике у Скупштини** **All Members of the Assembly**	**DATA** **ДАТУМ** **DATE**	**5 Korrik 2002** **5 Јула 2002.година** **5 July 2002**
NGA / ОД / FROM	**Franck Boulin** Ushtrues i detyrës së Sekretarit të Kuvendit /Вршилац дужности Секретара Скупштине / Acting Secretary to the Assembly		per Claressa Surtees
SUBJEKTI **ПРЕДМЕТ** **SUBJECT**	**Mbledhja e Kuvendit / Заседање Скупштине / Meeting of the Assembly**		

Mbledhja e ardhshme e Kuvendit do të mbahet:

Të enjten më 11 Korrik 2002 në orën 10:00
Në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës

Ftohën të gjithë Deputetët e Kuvendit të marrin pjesë.

Rendi i ditës është i bashkëngjitur.

Следећа седница че бити одржана:

Четвртак 11 Јула 2002 у 10.00 часова
У Скупштинској Сали у згради Скупштине Косова

Сви Посланици се позивају да учествују.

Дневни ред је у прилогу.

The next meeting of the Assembly will take place on:

Thursday 11 July 2002 at 10.00 am
Assembly Hall, Assembly Building, Pristina

All members of the Assembly are invited to attend.

The agenda for the meeting is attached.

zë të mbizotroj
ија савладати
prevails

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Prezentimi dhe leximi i parë i Projektligjit Nr. 2002/2 *për arsimin e lartë në Kosovë*
3. Prezentimi dhe leximi i parë i Projektligjit Nr. 2002/3 *për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë*
4. Rezimeja e debatit mbi mocionet e Qeverisë dhe Amandamentet e propozuara në seancën e 04korrikut 2002 për komunitetet dhe anëtarë e tyre në lidhje me kushtet e kthimit të refugjatëve dhe të zhvendosurve
5. Parashtrimi i pyetjeve

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са прошле седнице
2. Представљање и читање Нацрта закона бр.2002/2 о *високом образовању на Косову*
3. Представљање и читање Нацрта закона бр.2002/3 о *основном и средњем образовању на Косову*
4. Резиме расправе о предлогу Владе и Амандманима поднетим на пленарном заседању од 04јула 2002 године о мањинским заједницама и њиховим члановима у вези са условима за повратак избеглица и расељених лица
5. Постављање питања

AGENDA

1. Approval of minutes
2. Presentation and First Reading of Draft Law No. 2002/2 on *Higher Education in Kosovo*
3. Presentation and First Reading of Draft Law No. 2002/3 on *Primary and Secondary Education in Kosovo*
4. Resumption of debate on draft motion from the Government, and on amendments proposed in the plenary on 4 July 2002, on communities and their members and on the conditions for the return of IDPs and refugees
5. Questions

KUVENDI I KOSOVËS MBAJTUR MË 11.7.2002

KRYETARI NEXHAT DACI

Pika e parë.

Pika e parë, aprovimi i proçesverbalit nga mbledhja e kaluar.
E dyta, shqyrtimi i parë i projektligjit për arsimin e lartë në Kosovë,
Tre, shqyrtimi i parë i projektligjit për arsim fillor dhe të mesëm në Kosovë dhe
Katër, rezimea e debatit mbi mocionet e Qeverisë dhe amendamentet e propozuara në seancën e 4 korrikut për komunitete dhe anëtarët e tyre, prandaj pyes a ka dikush ndonjë pyetje, a aprovohet rendi i ditës.
Vazhdimisht 7 muaj i kemi të njejtat probleme, të komunikimit përkthimit, gjuhësor në komunikmin e shkruar, dokumetet e shkruara,

XHAVIT HALITI, PDK

Mendoj, që procesverbali nuk ka të bëjë vetëm me çështjet e drejtëshkrimit, të lekturimit, ose ata që i pëpilojnë procesverbalet kalojnë çështje shumë të rëndësishme që janë diskutuar dhe propozuar në këtë Parlament dhe në veçanti do të jepja vërejtje për propozimin tim rreth procedurës që është ndjekur në mbledhjen e kaluar. Unë nuk jam një diskutues i radhës qysh e ka nxjerrë këtu, ai që e ka shkruar për çef të vetin këtë procesverbal, ose ai që se ka dëgjuar këtë procesverbal, ose ai që s'është interesuar që zëri i deputetëve në të procedohet në mënyrë të regullt njësoj për të gjithë. Unë kam kërkuar decidivisht që propozimi i Qeverisë për ligjin të hedhet në votim dhe pjesa shtesë e propozuar të propozohet si ligj i veçantë, për fatin një shtesë e tillë në ligjin e propozuar do t'i detyrojë mekanizmat që ta kthejnë pas në rishqyrtim nëpër komisionet dhe mendoj se nuk do ta konsiderojë si ligj të miratuar. Të njejtën gjë e ka bërë edhe Kryesia, Kryesuesi i seancës ka hedhur në votim propozimin e dytë që mendoj sipas rregullit procedural nuk ka qenë e rregulltë.

Rreth kësaj mendoj se edhe kryesuesi edhe përpiluesi procesverbalit ose propozimet tona, kur janë thelbësore në veçanti propozimi i Qeverisë do të duhej të hedhej në votim si propozim i veçantë. Në rastin tjetër, hedhet propozimi tjetër, miratohet ose nuk miratohet. Mendoj se ky procesverbal kështu nuk duhet të miratohet dhe propozoj nga ky Kuvend që procesmbajtësit e këtyre procesverbaleve të pushohen nga puna nga Parlamenti dhe nga Kryesia e Kuvendit. Ju falemnderit.

NEXHAT DACI

Shkojmë në pikën e dytë të rendit të ditës,

RANDJEL NOJKIĆ KP

Gospodine predsedniče, dame i gospodo,

Mislim da opet kršimo neka pravila i procedure, još nismo se ni izjasnili za dnevni red već se prelazi na prvu tačku dnevnog reda, nije se glasalo, i ja sam za malo bio uskračen da ne mogu da izađem da izložim svoje primedbe na zapisnik. Mislim da to nije u redu.
Pre svega, želim da vam kažem da je zapisnik veoma važan dokument, i zapisnik mora da bude verodostojan,nažalost on kad je u pitanju koalicija Povratak i kada su u pitanju ljudi koji govore za ovom govornicom vrlo često se iskrivljuju njihove reči i vrlo često se pogrešno interpretiraju i to mislim da nije u redu i da treba jednom da se stane na put tome.
Takođe, zapisnik je veoma kontradiktoran, na samom početku rečeno je da je dnevni red bio usvojen i da se prešlo na dnevni red a odmah iza toga u zapisniku stoji da je gosposdin Gojko Savić dao primedbe na dnevni red, prema tome mislim da to treba da se konstatuje da je bilo odmah primedbi na dnevni red, a ne da se bez ikakvih primedbi prešlo na dnevni red.Verovatno će i sada isto tako da se ovaj interpretira.
Poslanik koalicije Povratak, g. Liljana Kenić nije rekla ono što stoji u zapisniku, nije rekla da ona traži da se odloži ovaj zakon zato što komisije nisu dale svoje mišljenje, nisu raspravljale o tome, već zato što nije dostavljen materijal na vreme to su dve vrlo

bitne stvari i razlike i mislim da oko toga ne bi trebali da se sporimo. Dalje, neprihvatljivo je da neke možda manje važne ili za nekoga možda manje važne stvari zauzmu veliki prostor u zapisniku a opet da neke druge koje su vrlo važne stvari koje se ovde iznose da se one uopšte ne pominju. Znate, mi možemo da razgovaramo o odlukama i odluke su nešto drugo, ali ono što se ovde kaže u zapisniku mora da uđe, tu nema glasanja, razumete da li se nekome sviđa da se nešto stavi u zapisnik ili se nešto ne sviđa, ja sam konkretno govorio o kršenju pravilnika, i poslovnika o radu ove Skupštine. Ni jedna reč tu nije iznešena i i lepo sam rekao da ne bi dalje išli u nekakve greške i pozvao sam se na kršenje poslovnika o radu tačka 28, 29, 30, 31 kada se radi o donošenju zakona, odnosno učešću Komisije za prava i interesa zajednice i da je neophodno i da to vrlo jasno stoji i u Poslovniku i u ustavnom okviru i da se to nije poštovalo i mi tražimo da to u buduće bude praksa kod donošenja svih zakona: Dalje, G.Stojanka je ovde govorila kao predsedavajući Komisije. Ona je diskutovala o zakonu i dala vrlo bitne primedbe, ali one nisu se usvojene ali svejedno mora ovde da stoji što je ona dala razliku između konsolidovanog budžeta i Kosovskog budžeta. To su razlike i mi tražimo da se te razlike, odnosno da se onako kako to naši poslanici kažu, da to stoji ovde u ovom zapipsniku. Molim vas posle razlika i to bitnih razlika kod donošenja odluka, u osnovnom okviru stoji jedna konstatacija koje su to puno važne odluke, a u uprivremenom poslovniku stoji sasvim druga konstatacija tako da prošli put, kada se razgovaralo o sudijama, po meni prema ustavnog okviru, ova odluka nije validna obzirom da je od 84 poslanika samo 34 glasalo za, a da vrlo jasno u .

NEXHAT DACI

Z. Nojkiq, ju lutem nuk kemi për diskutim, shumëkush ka vërejtje në procesverbal.
Në procesverbal keni të drejtë. Unë ju pyeta, nuk do ta aprovojmë, prandaj ju lutem mos na mbani leksione këtu.

NOKIĆ

Nisam imao prevod molim vas. Ja imam konkretne primedbe na zapisnik i želim da me saslušate i govorim o konkretnim stvarima, a ako ne znam zašto, ako vam se ne sviđa,

to je posebna stvar. Takođe imam primedbu na zapisnik, kada smo govorili, to je i u zapisniku zapisano, u vezi termina Kosova i Metohija. Vi ste taj termin. (nderhyrje e Dacit) nuk e aprovojmë këtë verejtje, proceverbali nuk eshtë.

Ka vëtejtje serioze në procesverbalet sa i përket rendit të ditës. E dyta, duhet informuar një pjesë e deputetëve se inçizimi në fjalë përfjalë tonik dhe video do të bëhet. U konsultuam me sekretarin që në vjeshtë të krijohet shërbimi i veçantë për krimin e dokumenteve të shkruara. Shpresojmë se ato dokumente do të jenë në nivel që do t'i kënaqin të gjitha aspektet, profesionale dhe gjuhësore edhe shqip edhe serbisht. Prandaj, mos e shfrytëzoni foltoren për debate për promovime për marketing pa lidhje. Kjo vlenë për të gjithë në qoftëse ka. Unë ju pyeta a aprovohet, në qoftëse duhet të votojmë për rendin e ditës, po votojmë. A ka dikush që don të propozojë diçka të re në rendin e ditës. Urdhëro Kelmennd.

Z. KELMENDI

I nderuari kryetar, të nderuarë deputetë,

Do të ishte mirë që në rend dite të vëhet kjo pikë, informatë e deputetëve lidhur me materialin që është nxjerrë nga Kuvendi dhe armatimin që është gjetur në Kuvend. Së paku të informohemi se çka ka ndodhur rreth kësaj. Ju falemdnerit

NEXHAT DACI

Kur të jetë informacioni i plotë, kur të kryhen të gjitha hetimet dhe të dihet e tërë e vërteta, unë pajtohem që do të jetë në rend ditës, por sot nuk jemi të përgatitur.

RANDJEL NOJKIĆ

Ja se izvinjavam, morao sam da izađem i da intervenišem, pošto ste me bili prekinuli u svom izlaganju. Neću da govorim o zapisniku, a želim da govorim šta se desilo prošlog

puta, da se ne desi ovog puta. Prošli put novinari koji prate ovaj parlament iz srpske zajednice nisu imali nikakav prevod i uopšte nisu mogli da prate zasedanje. Molim vas da se preduzmu odgovarajuće mere i da se omogući svim novinarima da mogu da prate debate.Ovaj klasičan primer deskriminacije je u suprotnosti.

NEXHAT DACI

Ju lutem zotëri deputetë,
Unë po e vlerësoj që është e panevojshëme që po tensionohet. Sekretari thotë se të gjithë gazetarët i kanë të gjitha pajisjet që i kanë gazetarët dhe nuk kemi nevojë të humbim kohë rreth kësaj.

SABRI HAMITI LDK

Z.kryetarë, zotëri deputetë,

Ne u muorëm vesh që ai procesverbal nuk është i hartuar as profesionalisht as në nivelin gjuhësor siç e meriton Parlamenti. Unë kam edhe vetë vërejtje substenciale dhe nuk do të flasë për te. Unë të thërras edhe një herë Kryesinë dhe kryetarin e Kuvendit që mos shtrojnë rendin e ditës edhe një herë se shkojmë pa kufi. Ne kemi votuar për rendin e ditës dhe ju lutem shumë nuk ka nevojë që të japim propozimet të pastudjuara këtu në sallë. Unë kërkoj që të fillohet të punohet me rend dite.

Z. KELMENDI

Unë kam një propozim praktik, që Pralamenti të mos shndërrohet në miting kufizoni kohën e debatit, le t'i përbahet kohës së debatit secili deputet Parlamenti mos të shërbejë këtu për promovimin e partive apo interesave poilitike, por le t'i shërbejë koha për mbarvajtjen e punës së Parlamentit.

Urdhëroni z.

(kryetari i Komisionit për buxhet)

Lidhur me rendin e ditës unë do të propozoj, propozimin inicial që ka dhënë Komisioni për buxhetin e Kuvendit të Kosovës që sot të shtrohet në rend dite, rekomandimi i tij për financimin e partive politike, është propozim inicial dhe mendoj që shumë imidiat për partitë që të nxerrim një vendim apo një rekomandim për Qeverinë që të sjellë mundësinë e finansimit të partive politike nga buxheti i Kosovës.

NEXHAT DACI

Ishte kryetari i Komisiomt për buxhet. Unë i thash që në këtë kohë Kosova ka prioritete shumë më të rëndësishme dhe ligje se sa finansimi i partive për buxhet. Unë i thashë se do të vjenë në rend dite një ditë tjetër, por ju lutemi që të punojmë.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, e atë para se t'ia jap fjalën ministrit përkatës, lus për një çështje. Shqyrtimi i parë i ligjeve për arsimin e lartë dhe atë të mesëm dhe fillor. I lus deputetët, anëtarët e sekretarisë lë të kalojnë, lë të paraqiten në fillim ata deputet që e kanë lexuar ligjin që janë të përgatitur që dëshirojnë të debatojnë, dhe e dyta, Jemi marrë vesh para fillimit me shërbimet profesionale dhe legale pas debatit në seancën plenare tri komisionet përkatëse për këto çështje, Komisioni për arsim.Komisioni për financa dhe ai i komuniteteve t'i shqyrtojmë propozimet e dala në këtë, në mënyrë, që në shqyrtimin e dytë që në fund të seancës do ta caktojmë jemi më kompletë, prandaj lë të paraqitet çdo deputet që është përgatitur për këtë prandaj ju jap fjalën.

Urdhëroni z. Ministër

REXHEP OSMANI, LDK

Z. kryetar, e nderuara Kryesi, të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinjë,

Kam kënaqësinë e veçantë që sot në Kuvendin e Kosovës të japë ekspozenë më parë për ligjin për arsimin e lartë,një rezime ekzekutive të projektlijgjit, në mënyrë që të kemi

mundësinë e debatit të të diskutimeve në parlamentin e Kosovës, pas shqyrtimeve të këtyre projektligjeve në komisionet e përmendura nga kryetari i Kuvendit.

Projektligji për arsimin e lartë të Kosovës do të sigurojë bazën e nevojshme juridike për një zhvillim stabil të arsimit të lartë në Kosovë për vazhdimin e sukseshëm të reformave kompatibile me standardet ndërkombëtare dhe për inkuadrimin e arsimit të lartë të Kosovës në proceset zhvillimore universitare ndërkombëtare . Kjo bazë juridike do të zë vendin e legjislacionit të imponuar para vitit 1989, me të cilën është rregulluar sistemi arsimor në fillim të viteve të 90-ta si dhe të akteve të përkohëshme juridike në formën e dekretligjit me të cilën është zhvilluar kjo veprimtari në vitet e zhvillimit për procesin mësimor jashtë objekteve publike shkollore dhe universitare.

Kuadri ligjor i mëparshëm është bërë pengesë e zhvillimit progresiv të arsimit të lartë në Kosovë në mënyrë që ky i fundit të ecë krahas me arsimin e lartë evropian dhe të jetë konkurent në tregun e punës dhe të dijes. Për këtë qëllim Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka nisur procedurën për nxjerren e ligjit të ri në bashkëpunim me Këshillin e Evropës. Ky ligj do të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare duke marrë për modele ligjet e ngjashme të vendeve përendimore, të cilat këtë fushë e kanë më të avansuar.

Në hartimin e këtij projektligji kanë punuar ekspertë të njohur ndërkombëtar, një grup i ekspertëve të Këshillit të Evropës në fushën e arsimit të lartë dhe kanë marrë për bazë legjislacionet e fushës përkatëse të Këshillit të Evropës. Parimet të cilat janë marrë në bazë për hartimin e ligjit të propozuar janë: Pajtueshmëria e arsimit të lartë në Kosovë në standarde dhe kërkesa evropiane. Projektligji siguron grada shkencore dhe strukturë të përmbajtjeve mësimore në përputhje me standardet evropiane dhe me frymën e deklaratës së Bolonjës. Ligji do të sigurojë parakushtet që kualifikimet e arsimit të lartë në Kosovë të njihen në vendet evropiane. Po ashtu ligji me shkallën akademike, dhe me sistemin e kredive, studentëve kosovarë u krijon mundësi bashkëpunim e konkurencë e dije dhe në tregjet e punës, brenda dhe jashtë Kosovës.

Dy, standardet e kualitetit të arsimit të lartë në Kosovë, kushtet për lecensime dhe akreditim, do të plotësohen dhe të aprovohen nga një agjensi e krediduese e Kosovës e cila do të sigurojë që të gjitha institucionet e arsimit të lartë do të punojnë në përputhje

me standardet qendrore të vendosura. Revizionet e herëpasherëshme do të sigurojnë që të gjitha instituticonet e arsimit të lartë t'iu përbushën standardet e këtilla.

Tre, Autonomia e institucioneve dhe të drejtave të individëve . Ligji do të sigurojë lirinë e mësimëdhënësve dhe hulumtimin brenda kufirit të ligjit dhe të pamundësojë intervenimet dhe ndikimet e autoriteteve publike në këtë fushë. Insititucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë t'i zgjedhin autoritetet drejtuese, të përcaktojnë kur ulen dhe të zgjedhin vendin ku do të japin mësim. Liritë akademike, për mësimdhënës dhe për studentë, do të jenë të garantuara,

Katër, Mbrojtja e interesit të komuniteteve. Duke iu referuar të drejtave të komuniteteve dhe të drejtave të tyre përmes përfaqësuesit special të Sekretarit të Përgjithshëm të bazuar nga Korniza Kushtetuese, ligji do të ndalojë çdolloj diskriminimi dhe do të sigurojë të drejtat e komuniteteve. Këto të drejta do të mbrohen dhe të sigurohen edhe nga nivelet qendrore.

Pesë, Transparencë në vetëqeverisje, menaxhim dhe finansim në të gjitha nivelet.Përmes fuqisë për aprovim të statutit të institucioneve të arsimit të lartë, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë siguron që kërkesat për transparencë dhe pjesëmarrje të personelit dhe të studentëve në vendimmarrje të jenë të njohura. Organet e Qeverisë dhe revizionet e rregulla sigurojnë efikasitet. Ministria mund të nxirë furnizuesit duke fokusuar finansim shoqëror.

Gjashtë, Vemendja publike lidhur me institucionet private, përmes licensimit akreditimit dhe revizionit Ministria do të sigurojë që institucionet private të arsimit të lartë do të plotësojnë standardet e njejta kualitative me institucionet publike. Ju falemdnerit.

HAJREDIN KUÇI

I kërkoj falje deputetit,

Puna sa më efektive, është e rrugës që t'i japim disa s'qarime. Fillimisht dua të them se jam i nderuar se në emër të Komisionit për arsim, shkencë dhe teknologji, do t'i shprehë mendimet e komisionit këtu dhe njëkohësisht jam i nderuar që marr pjesë në shqyrtimin e një ligji, mund të them të ligjit të parë për arsimin e lartë në Kosëvë, i cili është pas

luftës, ndërsa para luftës e dimë se arsimi i lartë ka qenë një ndër institucionet që më së pari është larguar nga sistemi paraprak.Fillimisht mund të them se në emër të komisionit kemi bërë dy lloj shqyrtime, se shqyrtimet e para kanë qenë shqyrtime parimore, ndërsa shqyrtimet tjera kanë qenë përmbajtësore, të cilat kanë shkuar nen për nen.Unë sot këtu nuk do të ndalem pasi atë e kemi marrë me shkrim në emër të komisionit, por dua ta falenderojë komisionin për një punë konstruktive. Mund të them se brenda komisionit kemi pasur diskutime të ndryshme, votime kryesisht me shumicë, por ligji për arsimin e lartë ne fund është aprovuar me koncenzus me votimin e të gjithë anëtarëve, pa marë parasysh përkatësinë e tyre, partiake etnike etj.

Në emër të komisioneve në fillim mund të them ndoshta vrojtimet personale të mia ndoshta lidhur me shqyrtimin e ligjeve nuk po respektohet dispozita 9.1 e Kornizës Kushtetuese për vetëqeverisje të përkohëshme, po ashtu edhe dispozitat 29,30 dhe 31 të regullores së përkohëshme të punës së Kuvendit nga se mendoj se sot nuk duhet të jetë shqyrtimi i parë ose në qoftëse është sot shqyrtimi i parë nuk duhet ta shqyrtojmë prapë. Mendoj se Kryesia e Kuvendit, respektivisht ushtruesi i detyrës së sekretarit duhet të jetë i kujdesëshëm. Këtë procedurë ligjore duhet ta respektojë. Mund të them me përgjegjësi se ky ligj për arsimin e lartë kemi pasur parasysh që ka përfshirë mundësinë e barabartë për të gjithë, shkollim në arsimin e lartë për të gjithë njerëzit në Kosovë në kushtet e barabarta. Komisioni ka qenë jashtëzakonisht i kujdesshëm për kompetenca që mund t'i ketë Ministria e Arsimit, Shkecës dhe Teknologjisë në raport me autonominë e institucioneve të arsimit të lartë. Kemi tentuar që të respektohet autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liritë akademike. Po ashtu kemi mundësuar që të krijohet apo të nxitet aftësia konkuruese në institucionet e arsimit të lartë përfshirë ato publike, por kemi mundësuar edhe krijimin institucioneve private të arsimit të lartë ,

Natyrisht në veçanti janë shqyrtuar edhe të drejtat e studentëve, të dretjat e të tjerëve në universitet dhe mënyra e financimit. Kemi pasur disa dilema. Në fund do ta them dilemën kryesore për të cilën duhet të diskutoj në mënyrë serioze ky Kuvend. E para dilemë ka qenë dhe pastaj kemi marrë sqarime nga ministri i Arsimit se trajtimi i isntituteve shkencore, pastaj trajtimi i gjendjens së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe një dilemë tjetër rreth kontinuitetit të Univerzitetit të Prishtinës. Këto kanë qenë tri dilema jashtëzakonisht serioze. Për dy dilemat e para, për institutet shkencore

dhe për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës kemi marrë sqarim se do të përgatitet një ligj për veprimtaritë shekncore, ndërsa sa i përket kontinuitetit të Universitetit të Prishtinës, mendoj sot ky Kuvend duhet të mendoj dhe të diskutojë seriozisht. Dilema kryesore e këtij Kuvendi, kam dëshirë që t'ia paraqesë edhe pse paraqitja imje nuk është zyrtare pasi që edhe unë jam informuar në mënyrë jozyrtare gjatë shqyrtimit të projektligjit për arsimin e lartë, kemi hasur në një defekt jashtëzakonisht serioz, në radhë të parë nga se në gjuhën shqipe në pjesën e 10, 10,7 në gjuhën serbe dhe angleze mungon një dispozitë. Në gjuhën shqipe nuk ekziston fare shqyrtimi apo dispozita për të ashtuquajturën universitet të Kosovës veriore, ndërsa në gjuhën serbe dhe angleze ekziston një dispozitë e tillë, dhe përveq që përmendet në dispozitën 10.7 në gjuhën serbe dhe angleze aty thuhet se universiteti i Kosovës veriore është universitet i licencuar. Unë me insistimin bashkë të anëtarëve të komisionit, kemi kërkuar që kjo çështje të mos diskutohet në komision, pasi që komisioni nuk ishte për objekt shqyrtimi në gjuhën shqipe, por kemi menduar se kjo i takon nivelit më të lartë në këtë rast Kuvendit të Kosovës. Mendoj që paraprakisht ky Kuvend duhet të diskutojë shumë seriozisht ngase e them një krahasim në aspektin juridik. Sipas Kornizës Kushtetuese në pikën 14/4 aty thuhet, në rast të inkopatibilitetit në mes të gjuhëve të ligjeve apo akteve tjera juridike, atëherë vlenë interpretimi në gjuhën angleze.Sipas kësaj logjike, atëhere ne do të votonim për një dispozitë të tillë, e cila ekziston në gjuhën angleze.

Konsideroj se Kuvendi ka nevojë të votojë për këtë dispozitë dhe kam dëshirë që të harmonizojë në tërësi apo 100% tekstin në gjuhën shqipe serbe apo gjuhën angleze.

NEXHAT DACI

Unë e kuptoj që gjuha e punës në Qeveri dhe në Parlament është gjuha shqipe, por të barabarta në Parlament janë edhe gjuha serbe edhe gjuha angleze. Prandaj për këtë arsye edhe ne sot që pas debatit të përgjithshëm përsëri duhet të tubohen komisionet, të grumbullojnë, të sintetizojnë për atë që u tha këtu në mënyrë që në shqyrtimin final kur të aprovohet vërtetë të kemi përmirësime, atëherë kur është nevojshme .

RAMADAN KELMENDI, LDK

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, i nderuari ministër,

Duke mbështetur të drejtën e deputetit për të marrë pjesë në diskutimin e dhënë amendamente si dhe faktin se Kuvendi është më i lartë ligjëdhënësi, unë paraqes këto amendamente me këtë projektligj për arsimin fillor, të mesëm dhe një amendament për atë universitar duke propozuar që në fillim këto ligje të miratohen, (ndërhyn Nexhat Daci). Më falë zotëri deputet, tash diskutohet vetëm për ligjin për fakultetet për universitetet për shkollimin fillor. Ju lutem.

Z. Kelmendi. Tërhiqem nga ajo, pasi që këtë informatë e mora. Kam dy çështje dhe dy amendamente me ligjin për universitetin. Në kapitullin e tretë, pjesa 27, pranimi i studentëve. Duke u mbështetur në një padrejtësi që bëhet rreth pranimit të studentëve kërkojë që të mos bëhen padrejtësi për fushat e veçanta të studimit të arsimit të lartë, për interes t ë p ërgjithshëm të K osovës. N ë m arrëveshje m idis M inistrisë d he i nstitucionit gjegjëse që bënë regjistrimin e studentëve, të përcaktohet një numër i caktuar i studentëve të regjistrohen nga regjionet e caktuara të Kosovës dhe e dyta. Nuk kam nevojë të përsëris, duhet të shqyrtohet dhe të hiqet universiteti i pjesës veriore të Mitrovicës, si pjesë e paraparë që po ekziston. Ju falemnderit.

NEXHAT DACI

Edhe një sqarim, për diskutuesit tjerë. Në shqyrtimin e parë nuk ka amendamente, debati i përgjithshëm, sipas juristëve. Prof. Arsim Bajrami edhe ashtu e ka kërkuar fjalën.

ARSIM BAJRAMI

Edhe në një mbledhje të kaluar kemi kërkuar nga shërbimi i Kuvendit që me të vërtetë ta sqaroj procedurën ligjëdhënëse, për shkak se unë e mbroj mendimin që është leximi i dytë i ligjit për shkak se leximi i parë i ligjit ndodhet në komisionet parlamentare. Pasi që propozimi ligjëvënës të vie në parlament, atëherë në komisionin adekuat funksional

dhe parlamentar dhe në komisionin kryesor në qoftëse invulvohet kjo punë, bëhet leximi i parë.

Gjatë leximit të dytë shqyrtohet edhe drafti i propozuar nga Qeveria, por edhe amendamentet që kanë ardhur nga komisioni funksional. Unë kërkoj nga shërbimi i Kuvendit dhe nga Kryesia që në një mbledhje të Kryesisë të miret në një mënyrë të veçantë që në mënyrë ta kemi të qartë cila është procedura ligjëvënëse.

Sa i përket ligjit në fjalë mund t'ju them se që sot po diskutohet për një ligj shumë të rëndësishëm, ndoshta ligji i parë sistemor, një ligj i cili i adresohet gati gjysmës së popullatës së Kosovës. Unë parimisht do të shprehi mendimin e Universitetit të Prishtinës, meqenëse përfaqësoj këtë institucion. Duke pas parasysh bazën e ligjit, mendoj se para nesh ndodhet një ligj me të vërtetë me standarde evropiane, i cili pretendon ta coptojë trenden bashkohore në lëmin e arsimit të lartë. Aktualisht, në nivel të Evuropës ka filluar një proçes që quhet krijimi i zonës evropiane të arsimit të lartë. Ky proces është më tepër proces politik,meqenëse se shumica e ministrave të arsimit, kanë nëshkruar të ashtuquajturën deklaratën e Bolonjës, e cila pretendon deri në vitin 2010 të krijojë një treg unik të arsimit të lartë, që do të mundësojë një qarkullim të dijeve dhe diplomave akademike. Ësht fatë i mirë se në hartimin e këtij ligji kanë punuar ekspertët e Këshillit të Evropës, që janë të involvuar për krijimin e projektet për arsimin e lartë . Ajo që bie në sy është vërtetë ikja nga formalitetet e legjislacionit të kaluar dhe dezideolizimi i legjislacionit. Pra, u krijuar një legjislacion që pretendon me të vërtetë të futet vlera çfarë i duhet arsimit të lartë.

Unë kam këtu afër 30 amendamente. Nuk di a është koha t'ia dorëzojë komisionit. Duhet të miremi vesh, 30 amendamete të cilat i ka miratuar Senati i Universitetit, i cili është një lloj parlamenti i universitetit në të cilët përfaqësohen të gjitha institucionet. Do të ndalem vetm në tri momente. Meqenëse po e rezervoj të drejten që të diskutojë edhe për leximin e dytë të ligjit, ndoshta edhe do t'i arsyetojë këto amendamente. Do të ndalem te procedura që po ndjekë Qeveria rreth miratimit të ligjeve.

Edhe me rastin e miratimit të programeve të Qeverisë, atëhere kur ky Parlament ia ka dhënë votëbesimin Qeverisë dhe përbërjes, kanë diskutuar dhe kanë kërkuar që Qeveria të jetë shumë transparente me rastin e hartimeve të ligjeve. Përzgjedhja e Qeverisë është bërë sipas kritereve politike dhe duke pasur parasysh se Qeveria akoma nuk është e

plotësuar me ekspertë të fushave të ndryshme, kam kërkuar që projekt ligjet që propozon Qeveria të jenë transparente për opinionin dhe të përfshihen ekspertë të fushave të ndryshme. Mendoj që edhe me rastin e këtij ligji, është dashur të ndjeket një procedurë më transparente. Pra jo vetëm që t'i lihet kjo punë ekspertëve të Këshillit të Evropës, por të përfshihen edhe ekspertët vendorë, në mënyrë që ligji vërtetë të akceptojë realitetet e Kosovës. Meqenëse ligji mund t'i detalizojë përvojat evropiane, do të doshtojnë .në qoftëse nuk merr parasysh edhe përvojat dhe gjendjen të cilën ne ndodhemi në këtë fazë të tranzicionit. Në këtë drejtim nuk ka pasur një trasparencë dhe përfshirje e subjekteve të interesuara. Ligji është diskutuar kryesisht në organet e Qeverisë pa marr opinionin e universitetit të Prishtinës. Mendoj se një diskutim i vogël i shkurtër publik për Universitetitn e Prishtinës do ta pasuronte me përvojat që ka Unviersiteti.

Do të ndalem vetëm në tri momente të cilat edhe u cekën.

Momenti i parë është i të drejtës në arsim të lartë është për komuniteteve që paraqesin minoritete. Mendoj se kjo çështje është rregulluar në mënyrë shumë të përgjysmuar në nenin 4 pika e dytë të këtij ligji, ku parimisht u nihet e drejta në arsim të lartë e të gjithë qytetarëve, pa asnjë llojë diskriminimi.

Unë përkrahi këtë dispozitë. Do të kërkoj nga Qeveria dhe nga komisioni adekuat që ta precizojë këtë nen në atë mënyrë që e drejta në arsim të lartë për minoritete të mos nënkuptojë edhe të drejtën krrimin e të parëve institucioneve në baza etnike. Mendoj se brenda institucioneve ekzistuese publike dhe ato që do të formohen me këtë ligj, duhet mundësuar të gjithëve çasje të barabartë, të gjithëve integrim brenda universiteteve prej arsimit fillor deri te arsimi i lartë, por asesi të krijojmë bazë ligjore për krijimin e institucioneve paralele në baza etnike. Thjeshtë, po ndjekim në një politikë të segregacionit, e cila është ndjekur këtu me vite. Tani plotësisht me ligj kjo duhet të pamundësohet, fatkeqësisht ne jemi pruar edhe pranë një realiteti faktik dhe të ashtuquajtur universitet të Kosovës veriore i cili siç dihet nga Univerziteti i Prishtinës asnjëherë nuk është pranuar për shkak që Univerziteti i Prishtinës ka shprehur gatishmërinë të vazhdojnë të shprehë gatishmerinë për integrimin e minoriteteve brenda Universitetit të Prishtinës. Ne kemi bërë hapat e integrimit të komuniteteve tjera, integrimit të komunitetit boshnjak e sivjet do të raktivizohet studimet në gjuhën amtare të integrimit të minoritetit turk. Nuk ka pasur asnjë kërkesë të sinqertë të minoritetit serb

për t'i integruar në Universitetin e Prishtinës. Po të ishte një kërkesë e sinqertë po edhe brenda universitetitit, por edhe Qeveria do të bënte përgaditjet që të riaktivizonte mësimin e gjuhës serbokroate. Kështu mendoj se edhe ajo që e ceku kolegu Kuqi, por edhe seriozisht të shqyrtohet meqenëse ka dallim në tekstin angisht dhe shqip, edhe se vërtetë Korniza Kushtetuese thotë se në rast dallimi do të ketë përparësi teksti në gjuhën angleze. Ne duhet krijojmë tekste shumë kompatibile.

Një segment tjetër, ne duhet të kemi shumë kujdes rreth asaj se çka paraqet liria akademike dhe autonomitë e institucioneve të arsimit publik dhe çka paraqet e drejta legjitime e Qeverisë për lëmin e arsimit të lartë. Kjo është shumë me rëndësi për shkak se tradicionalisht universitetet gëzojë autonomin,autonominë akademike,lirinë akademike procesverbalet akademike, mirëpo është edhe një fakt ligjor, se çdo shtet ligjor Qeveria ka ingirenca të caktuara në lëmin e arsimit të lartë në zhvillimin strategjik të arsimit të lartë dhe menaxhimin. Ka disa dispozita të cilat në një mënyrë atakojnë liritë akademike dhe autonomin e Universitetit në këto amendamente që do t'i dorëzojmë komisionet janë të tëra, një nga një dhe mendoj se ato duhet të diskutohen në mënyrë shumë serioze.

Një çështje është çështja e shtimit të cilësisë në lëmin e të arsimit të lartë. Ne në qoftëse dëshirojmë të bëhemi ndonjëherë anëtarë të familjes evropiane të arsimit të lartë, nuk do të bëhen vetëm me fjalë dhe reforma, por do të bëhem në qoftëse në arisim sigurojnë mekanizma, sigurojmë cilësi në nivel evropian. Dhe në këtë drejtim po bëhet një hap shumë i rëndësishëm nëpër mes të institucioneve të agjencisë për akreditimin për arsimin e lartë të Kosovës. Mendoj se ky institucione do të jetë një hap shumë i rëndësishëm në arsimin e lartë. Unë shpresoj se ai në përbërjen e tij do të ketë vërtetë ekspertë që posedojnë kualitete të cilat do të bëjnë ekuvalintimin e vlerave në arsimin e lartë. Ajo që më ka ra në sy është një dispozitë me përbërjen e këtij komisioni, e cili të ketë 9 anëtarë do të ketë 3 ekspertë ndërkombëtarë, dhe ekspertë tjerë vendorë. Parashifet që licencimi dhe akreditimi do të bëhet vetëm në qoftëse pajtohen të gjithë ekspertët ndërkombëtarë. Do të thotë parashihet një mundësi e të drejtës së vetos ndaj procedurave të licencimit në qoftë se për këtë nuk pajtohet një ekspertë ndërkombëtarë. Kjo është një shfaqje e mosbesimit ndaj institucioneve vendore dhe kemi nevojë për ekspertë ndërkombëtar, por jo më të drejtë të dyfishtë të votës. Në qoftëse kemi pranuar fuqitë politike dhe juridike të përfaqësuesit special në nivel të Kosovës me Rezolutën

1244 mos ta instalojmë këtë praktikë edhe në institucionet tjera të arsimit të lartë, kështu mendojmë në këtë aspektë vërtet duhet bërë diçka.

Edhe një çështje tjetër. Thash do të rezervojë të drejtë për të diskutuar më vonë, çështja e kompetencës për të krijuar institucionet e arsimit të lartë, do të thotë për të krijuar fakultete, universitete, për të krijuar departamente. Unë mendoj se do të ketë tri subjekte që vendosin për këtë çështje. Subjekti i parë duhet të jetë institucioni i cili adresohet vendimi i Qeverisë ku themelohet apo shuhet një universitet i ri, fillimisht ai subjekt duhet të konsultohet. Subjekti i dytë duhet të jetë Qeveria, përkatësisht Ministria e Arsimit, e cila në këtë drejtim duhet të ketë autoritetin e saj, ndërkaq vendimin definitiv duhet ta ket Kuvendi i Kosovës, për shkak se edhe Universiteti i Prishtinës është universitet publik që tani është themeluar me vendimin e ish Kuvendit të Kosovës,

Me qenëse kjo çështje është shumë e rëndësishme, unë mendoj se kompetenca përfundimtare duhet të jetë Kuvendi i Kosovës. Unë shprehi kënaqësi se kjo gjë është harmonizuar edhe brenda komisionit adekukat edhe për këtë është pajtuar edhe Ministria, pra po përfundoj me kaq, Ju falemnderit.

NEXHAT DACI

Ju lultem mos ta zgjasim për atë që është e panevojshme. Për këtë dhe besoj vendim, jo lutje në menenklaturën oficiele nuk do të ketë Kosovë veriore, Kosovë jugore, verilindore veriperendimore, prandaj ju lutem propozuese akteve ligjore, do ta keni parasysh këtë deklaratë.

SABRI HAMITI LDK

Kolegë të çmuar. Unë e konsideroj një solemnitet të veçantë punën që do ta bëjmë sot, evetualisht edhe nesër, do të shqyrtojmë dy ligje shumë të rëndësishme sistemore të cilat do të regullojnë veprimtarinë e madhe të arsimit, te ne u tha edhe para neve që kap drejtë përdrejtë reth gjysmën e popullsisë së Kosovës që është në moshë të re, të shkollimit, por në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë edhe krejt shoqërinë tonë . Menjiherë po them se pas leximit të kujdesshëm që kan bërë si individ si deputet të këtyre teksteve dhe

pas një shqyrtimi shumë shterrues dhe të thosha në dy mbledhje të Komisionit për arsim,të cilat kanë zgjatur për disa orë kanë arritur që të shoh dhe unë mendoj se janë të dyja ligje të mira tashpëtash po bisedojmë për ligjin për shkollimin e lartë e konsiderojmë një ligj të mirë, i cili siguristh se do të preçizohet me pika të dhe nene të veçanta me propozimet edhe të Komisionit për arsim edhe eventualisht me propozime tjera që do të dalin pas këtij shqyrtimi edhe në shqyrtimin tjetër. Ajo që është me rëndësi të veqantë do të thosha unë që e shoh në këtë ligj për arsimin e lartë është insistimi që të krijohet kuadri ligjor për zhvillimet e studimeve në nivel të lartë me pretendime që të kapin dijet aktuale që të jenë të krahasueshem në dijet që ndodhen kudo rreth nesh dhe në Evropë. Kjo natyrisht do të arrihet vetëm nëse sigurohen kushtet e barabarta dhe konkurenca, të cilat janë themelore për krijimin e kualitetit për gjitha lëmenjtë e veçanarisht në lëmenjtë e arsimit ku prodhohet dija dhe jipet dija në të njejtën kohë.
Kështu që ky element i krijimit të lirisë dhe barazisë para ligjit për shkollim edhe të konkurencës, vetëm kjo do të na qojë përpara dhe do të lejojë mundësinë që të krijohen kualitetet. Një element tjetër i rëndësishëm është projeksioni i lirisë, të menduarit jo në kuptimin e fjalës-shprehjes edhe tëmenduarit që hynë si kualitet dhe sanksionohet brenda këtij ligji. Kjo është shumë me rëndësi për universitetin tonë universitetet eventualisht të e reja që do të bëhen në Kosovë për shkak se përfundimisht mendimi i lirë, i cili është alfa dhe omega e kërkimit shkencor tash lejohet në studime dhe në të njejtën kohë , është atje në cilin nen nuk e di që më duket shumë sinifikativ dhe shumë i mirë lejohet që për problemet, njerëzit të shprehin mendimet e kundërta dhe mos tju meret për keq në kuptimin, pra sanksionohen. Po flas krejt për këto probleme sepse ne kemi një përvojë të keqe që në shkollimet e lartë në universitete ku prodhohet dija e re ai që ka botëkuptime dhe kërkime të reja të shkojë që është gjithmonë e natyrshme dhe shumica e sanksionon e denon. Ata shkelin një mundësi të tillë që njerëzit të shprehin pikëpamje të reja, të kultivojnë, të ndërtojnë të çojë tutje. Do të sanksionohet në filan fakultet a në universitet pse ai nuk po pajtohet me shumicën e shumica ka të drejtë të vendos për dije të reja. Ju e dini fort mirë, ata që punojnë në kërkime, dije të reja nuk ka me shumicë, ka me pakicë. Mua më pëlqen që ky element del në ligj, në anën tjetër unë pyeta që përfundimisht do të krijohen kushtet që të hynë në universitet dhe në shkolla të larta njerëzit më të mirë dhe që të krijohet një regull studimi, tash po e quajmë një rregull

të brendëshëm, ku precizohen, po më duket i suksesshëm pozicioni i mësimëdhënësve, kërkuesve dhe të studentëve këto janë elemente me rëndësi.

Kolegu Bajrami e përmendi, ne jemi kolegë edhe në universitet dhe na prekin këto probleme direkt. Nuk ka edhe reforma kur deklarohen e para, njëherë e dyta, nuk ka reforma për pa u krijuar raportet e reja në mes të gjitha anëtarëve që hynë në proceset e mësimeve dhe provimit të degëve dhe të përcillen. Është universiteti, sepse duhet të jetë elementi i mësimdhënësve tjetër nivel dhe elementi i studentëve. Këto dy elemente pa u sanksionuar mirë me ligj edhe nuk mund kryhen interkomunikimet që kërkohen. Këto tash nuk janë deri sot, unë pres që ky ligj të jep mundësi që të krijohen këto sjellje të reja. Shkurt nuk ka mësimëdhënie të fortë aty ku studentët nuk janë të përegatitur që ta kontestojnë tipin e mësimëdhënies së dobët. Nuk ka studentë të mirë aty ku nuk ka kushte të kërkimeve. Nuk ka mësimëdhënie të fortë në raste nuk stimulohet. Ju lutem, këtu duhet të flitet menjëherë sot edhe me ligjin edhe me kushtet e arsimit, ne tipin e pagesave të punëtorëve universitarë nuk ka reformë, dhe ne bisedojmë për këtë ligj, pse mos të bisedojmë edhe për të gjitha këto probleme që janë të lidhur njera me tjetrën. Kujtoj që ne duhet të lexojmë mirë me gjitha aftësitë që kemi këtë ligj dhe të aprovojmë dhe të kalojmë me punë konkrete sepse jemi para verës dhe vjeshta duhet të na gjejë me ligje themelore për arsimin në të gjitha nivelet, konkretisht kur kemi të bëjmë me arsimin e lartë dhe universitetet, ajo pika e vlerësimit që e përmendi kolegu im është shumë me rëndësi agjencia e kreditimit dhe unë pikpyetje që shtroja ta them edhe më tutje, edhe komisioni nuk e pranon. Ne mendojmë jo vetëm në agjenci të akreditimit, por edhe dy tre nene atje që përmendet, prania e të huajve kualiteti e etj. Në asnjë institucion demokratik, në asnjë institucion ligjerues nuk mund të ketë anëtarë më të vlefshëm ose më të pavlefshëm, çdo anëtar e ka fuqinë e vet të votës lë të hynë tre ndërkombëtarët 5 vendas ose 4 ndërkombëtar, kjo nuk ka rëndësi. Në votime, ne kërkojmë që vendimi të miret me shumicë. Nuk ka mundësi të bëj veto kurkush në një institucion ku e ka votnn e barabartë se është qesharake çfarë do të jetë motivimi i sajë. Në fund po e përmendi krejt edhe një çështje rreth këtyre gjuhëve. Ju lutem, trajtimi i gjuhëve në Kuvend është qesharak në praktikën e deritashme, ju merrne rendin e ditës dhe shihni se çfarë qesharake edhe shqipja besa edhe serbishtja, po janë njerëzit, lie të meren me atë punë, është punë e tyre dmth. tregon një pakujdesi totale. Mos haroni se gjuha jonë është

shqipja nuk është anglishtja, numër 1 në Kosovë, anglishtja është momentalisht gjuhë që hynë në fazën në komunikimit mes nesh.
Nën dy, asnjë ligj që e bën Kuvendi anglishtja s'ka pse të jetë apriori gjuhë kryesore. Kjo është absurde, ndërsa aprovohet teksti për ndërkombëtar krijohet në tri gjuhë dhe atëherë ne mund të flasim për një farë barazie në shprehje , por paraprakisht të apriorit thuhet i shpiket dhe thuhet e anglishtja është gjuhë kryesore. Ju lutem shumë, unë për veti po flas variantën në anglisht as që e kam lexuar, as që e kam shqyrtuar as që do ta shqyrtoj sepse Komisioni, organi që më ka sjell ma ka qit variantën shqip, kur të hartohet ligji, atëhere bisedojmë për referencat.

NEXHAT DACI

Ju lutem debat të përgjithshëm për propozim ligjin, mos të lidhemi për mendimet. Të gjitha këto që propozohen i shkojnë komisioneve, tri komisione prapë do ta shqyrtojnë në shqyrtimin përfundimtar dhe në votim do të jepen mendimet e Qeverisë dhe organeve.

BUJAR DUGOLLI

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë,

Edhe unë shprehi kënaqësinë time personale dhe të grupit parlamentar për fillimin e procedurës - miratimit ligjit për arsimin e lartë dhe për arsimin fillor dhe të mesëm. Mendoj që është ditë e shënuar për institucionet tona sepse po i bëjmë institucionet e edukimit të arsimit të Kosovës, të cilët i kanë mbijetuar dhunës, terorit dhe okupimit serb. Tani kemi rastin që të diskutojmë dhe të bëjmë vlerësimet tona për këtë punë që e kanë bërë ekspertët tanë dhe ekspertët ndërkombëtar, për të cilën punë i falenderojmë.
Grujpi ynë parlamentar jep një mbështetje parimore fillimit të kësaj procedure. Normalisht diskutimet tona të veçanta do të vazhdojnë edhe me seancat tjera, kur është e parapamë vazhdimi i procedurës, por si kërkesa parimore ne dëshirojmë t'i shtrojmë para Kuvendit dhe kërkojmë që ta respektojmë autonominë e universitetitit duke ju lejuar senantit të universitetit të institucioneve të shkollimit të lartë të bëjnë vlerësimet dhe

prezentimit e tyre me shkrim t'ia dërgojnë Kuvendit dhe të kenë mundësi t'i shohin gjithë deputetët që universiteti ka pasur autonominë e vet ka dhe duhet ta ketë. Kështu mendoj dhe ne duhet t'i marrim në shqyrtim kërkesat e tyre kur ato janë të gatshëm dhe nëse ata i kanë dhënë një dritë jeshile kësaj çështje.

Çështje tjetër që është shqetësuese për mua, dhe normalisht kërkoj përgjigjje edhe nga ministri se si të lejojë në tekstin anglisht në faqen 9 pika 10 .7 të futet në atë terminologji i ashtuquajturi universitet verior apo i Mitrovicës ku thuhet në atë tekst që është gjëja e licencuar dhe unë di se as Kuvendi i kaluar i sistemit komunistë nuk ka licencuar ndonjë universitet tjetër përveç universitetit të Prishtinës.

Ne do të votojmë si grup parlamentar vetëm për variantin shqip e jo për variantin anglisht dhe nuk do të pranojmë çështje tjera që janë probleme esenciale dhe shkaktojnë edhe probleme politike. Nëse dikush ka bërë përpjekje që t'i jep një konatacion politikë shkollimit siperior në Kosovë, atëherë nuk duhet të lejojmë këtë. Duhet t'u lejojmë gjitha pakicave që të marrin pjesë në edukimin e tyre t'u jepet mundësia simpas ligjit që në të ardhme të hapim procedura të regjistrimit qoftë fakultete në gjuhën e tyre përkatëse, qoftë edhe universitete private, por universitet tani për tani është një, dhe do të fillojmë nga kjo bazë dhe t'i lejojmë procedura tjera të mëtejshme të gjithë ata të interesuar që të bëjnë diçka të re. Ju falemnderit.

NEXHAT DACI

Asnjë ligj nuk vjen në shqyrtim në Parlament, si ligj i ministrit. Unë e kam me shkrim nënshkrimin e kryeministrit të Qeverisë dhe mos ti ftojmë në veçanti vetëm për kompliment ose për përgjegjësi ministrat.

CVETA VUJAČIĆ KP

Poštovani Predsedniče, uvaženo Predsedništvo, kolege poslanici,

Ja sam član Odbora za nauku i tehnologiju pri komitetu i pri ovoj skupštinskoj vladi.

Mi smo raspravljali o ovom nacrtu, raspravljalo se i pre nego što smo se nas dve uključile. Ja nisam bila ovde tu bila sam u Americi zajedno sa grupom poslanika tako da sam zapisnik dobila pažljivo ga pročitala i uočila neke zamerke primedbe itd.
Danas raspravljamo o veoma važnom prostoru, što rekoše moje kolege, pitanju i te kako visokog obrazovanja. Kako će se jedno društvo razvijati i ići napred zavisi od njegovog intelektualnog potencijala.Taj potencijal i nepresušni izvor je upravo univerzitet.Nacrt zakona o višem i visokom obrazovanju izrađen je od strane Saveta Evropske zajednice u duhu Holandske deklaracije. Radi se o reformi višeg i visokog obrazovanja gde su uključeni svi bez obzira na veru, nacionalnu, etničku i drugu pripadnost.Na odboru je primećeno a to je i ovde već rečeno, ja sada ponavljam.U jednoj rečenici u albanskoj verziji spominje se samo Univerzitet u Kosovskoj Mitrovici. Ali on se spominje u engleskoj i srpskoj verziji. Predlažemo da se sve tri verzije usaglase kao što je kolega predsedavajući rekao. Dalje, to su tačke na osmoj strani, deset šest i deset sedam .Dalje na istoj strani ispod člana 11.4 trebalo bi da stoji i član 11.5 te smatram da se Univerzitet severnog Kosova u Kosovskoj Mitrovici smatra agreditovanim do 31. avgusta 2004. godine kao i Univerzitet u Prištini. Zašto su ova dva univerziteta sada kojim slučajem odvojena,mi dobro znamo da je to bio jedan unuvrzitet. Univerzitet u Prištini kao takav mi smo mnogi prihvatili radili i zajedno i ja mogu sada odgovorno da kažem da je sa osnivanjem medicinskog fakulteta osnovan i Univerzitet u Prištini. Taj univrzitet je funkcionisao sve dotle dok se nije kadar stvorio na albanskom jeziku i na srpsokm. Što znači, on ima svoju tradiciju. Tako da ovaj univrzitet nije sada odvojen ilegalni i politički, kako ga kolege i vi sami niste na odboru promovisati. Znači, on ima svoju tradiciju i te kako važnu.Prema tome univerzitet je postojao i radio a onda se nastava stvarala dvojezično pa smo pohađali nastavu na albanskom i srpskom .Studenti su polagali ispite i nije bilo problema sve dok se desilo nešto što se desilo.A sada ponovo kažemo, ilegalni smo - nismo ilegalni, zvanični smo i hoćemo da radimo. Hoćemo da radimo na maternjem jeziku hoćemo da pređemo u Prištinu hoćemo da radimo u svoje institucije u kojima smo radili. Znači, ne želimo paralelne institucije ja nisam za to i ne želimo da nas tako tretirate i da nas tako gledate .Mi radimo samo na svom maternjem jeziku pod mnogo lošijim uslovima nego što se radi u Prištini.U onim prostorima, u onim prostorijama, u onim kabinetima gde smo zajedno radili.Bile su zajedničke katedre bilo je

svega .Sve to dobro znamo a sad od jednom pravimo neku apsolutnu famu, držimo da je to tamo ilegalno, to ne postoji i to je ovo. To je sve legalno, to nije paralelna institucija, to je institucija koja je postojala koja to treba da bude na ovim prostorima i treba da bude u Prištini pod istim krovom.Samo tako, ako hoćemo zdravu instituciju, možemo da radimo. Hvala vam.

MEVLUDE SARAQI

I nderuari z.kryetar, të nderuar delegatë,

Po ashtu edhe unë si gjithë deputetët jam shumë e lumtur që jam pjesëmarëse në këtë debat të ligjit mjaft të rëndësishëm për arsimin dhe kam obligim si deputete që vij nga Gjakova e autorizuar nga nxënësit dhe studentët e shkollës së lartë pedagogjike që të kërkojë.

Në ligjet që do të aprovohen për shkollimin e lartë duhet të konsultohet institucioni i shkollimit të lartë dhe themeluesi i tij për shuarjen apo zhvillimin e mëtutjeshëm të këtij institucioni. Për të diskutuar më tepër nuk e shoh të arsyeshme, sepse , këto kompetenca i ka Ministria e Arsimit, ndërkaq gjithësesi i propozoj Komisionit që këtë gjë ta merr për shqyrtim. Të flasë për historikun e Shkollës së lartë të Gjakovës nuk muj t'u mbaj leksion njerëzve që janë këtu kompetentë që kanë punuar dhe kanë zhvilluar arsimin. Është shumë me rëndësi që ky institucion është themeluar me 29.7. 1967 të cilin e ka miratuar edhe Kuvendi i Kosovës, pra pak kohë para themelimit të Universitetit të Kosovës. Këtë fazë të konkurseve nuk është përfshirë konkursi për regjistrim të studentëve të Shkollës së lartë pedagogjike në të gjitha drejtimet, të gjitha tjerat i përkrah natyrisht besaoj se Komisioni këte do ta ketë në shqyrtim.

ALUSH GASHI

I nderuari kryetar, të ndëruar deputetë,

Natyrisht se shkalla e zhvillimit të një vendi varet nga shkalla e zhvillimit të institucioneve arsimore dhe shkencore si dhe mundësisë së aplikimit të diturisë shkencore në atë territor të administruar sipas institucioneve demokratike . Andaj për ne është një rethanë jashtëzakonisht fatlume se ne sot miratojmë apo jo një procedurë të miratuar të një ligji, i cili do të evitojë disrkiminimin në edukim në Kosovë, një ligj i cili ka gjitha parakushtet që të ofrojë një perspektivë të gjithanshme për gjithë qytetarët e Kosovës, një ligj i cili do të krijojë kushte për ardhjen dhe dërgimin e diturisë, për komunikim të barabartë si në teritorin e Kosovës, ashtu edhe një bashkëpunim shumë të mirë dhe konstruktiv në institucionet tjera demokratike .

Kjo është shumë e rëndësishme. Puna tjetër është mendoj që është shumë e rëndësishme për Qeverinë e Kosovës, dërgimi i teksteve në Kuvend mos të krijojë konfuzion mos të dërgojë tekste paralele. Një tekst në gjuhën angleze apo serbe dhe një teks tjetër në gjuhën shqipe, sipas rregullores për punën e përkohëshme të Kuvendit të Kosovës apo të rregullores së miratuar nga z. Hakerup në nenin 36 është e përcaktuar qartë, që dokumetet e këtij Kuvendi përgatiten në gjuhën shqipe, në gjuhën serbokroate dhe mundësisht në gjuhët tjera. Unë mbështes idenë dhe nevojën që është domosdoshmëri që vendimet nga ky Kuvend të jenë edhe në gjuhën angleze, që do të thotë ajo e cila diskutohet dhe që vendimi i cili merret këtu të përkthehet në mënyrë shumë korrekte edhe në gjuhën angleze. Prandaj ftoj Kryesinë e Kuvendit, Komisionin për punë dhe Qeverinë që këtë ligj kaq të rëndësishëm të na jep kohë për një debat shumë konstruktiv mund të jetë një ligj i mirë, natyrisht dituria shkencore është shumë dinamike dhe së shpejti do të na nevojitet që edhe ky ligj të begatohet edhe me amendametet tjera pas miratimit dhe gjithësesi, për ne një ditë e shënuar si shejë e një porsperitetit të përgjithëshëm të Kosovës. Ju falemnderit.

SABILE BASHA

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë,

Projektligjin për arsimin e lartë të Kosovës e lexova me shumë vëmendje e aq më tepër që ka të bëjë me arsimin superior. Kosova siç dihet ka një popullsi të re që përbënë afro 50 % të popullatës deri në moshën 20 vjeçare. Është krejt normale që në Universitetin e

Kosovës të përfshihet një numër i madh i studentëve që në projektligj mendoj se duhet kushtuar hapësirë dhe vëmendje shumë më të madhe. Këtë barrë sot të arsimit të lartë e bartin mbi supet e veta si mësimëdhënësit, studentët, por edhe tërë popullata kosovare. Studentët tanë do të thoja pa mundësi se gjatë viteve të okupimit e dhanë kontributin e tyre më të madh patriotik. Të parët ishin ata që ngritën zërin kundër robërisë shekullore, të parët ranë dhe u dergjën në burgjet e pista anë e kënd ish-Jugosllavisë.

Gjatë luftë që bëri UÇK-ja ata ishin të parët në front, të parët në beteja ndoshta edhe ranë dëshmorë e tani do të ishte krejt e natyrshme që në ditët e lirisë atyre studentëve duhet një kujdes më i madh.

Përfshirja sa më e madhe e rinisë kosovare në universitet do të duhej të ishte detyrë parësore jona, por shtrohet pyetja se si t'iu krijojmë kushte më të mira për t'i dalë kësaj detyre sa fisnike aq edhe të shenjtë. Ne e dimë se Kosova pas luftës frymon më lirshëm, por e dimë se është e lodhur nga plagët e robërisë shumëvjeçare, familjet kosovare u demtuan rëndë ekonomikisht, tani vargu i të papunëve sa shkon e rritet për çdo ditë, ndërsa xhepi i studentit për çdo ditë tkurret e tkurret. Pagesat e taksat e ndryshme që paguan studenti në fakultete janë të llojllojshme, andaj për t'i dalur ndihmë kësaj pjese më progresive të shoqërisë propozoj që Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të merret me format e mënyrën e tejkalimit të tyre. Për ta zbutur sadopak situatën e vështirë të studenit propozoj disa forma dhe veprime të cilat do të ishin.

1. Që pranë Ministrisë të formohet fondi për dhënien e bursave të studetëve dhe kredive si dhe të gjenden forma tjera të donacioneve dhe ndihmave.
2. Që këto fonde të formohen nëpër komuna gjithandej Kosovës.
3. Të formohen kooperativat studentore që studentët gjatë stinës së verës mund të punësohen apo kur ata të kenë mundësi të punojnë gjatë tërë vitit.
4. Pagesa e regjistrimit të semestrave të sillet në suaza të kushteve aktuale bile kjo të vlejë për tri vitet e ardhshme,
5. Të investohet më tepër në përmirësimin e kushteve si në konvite dhe që të mos na përsëritet dimri i kaluar, kur studentët tanë ngrinin nga të ftohtit,
6. Po ashtu të përmirësohen kushtet në menzën e studentëve dhe mundësisht të shtohet numri i menzeve studentore.

7. Studentët, fëmijët e dëshmorëve të ranë në luftë të gëzojnë disa lehtësira dhe të kenë përparësi duke filluar që nga marrja e bursave dhe e ndihmave të tjera deri n ë k onvikte e t jera. N ë f und m endoj s e i nvestimet d he l ehtësirat n daj studentëve do të ndikonin pozitivisht në mbarvajtjen e punës sa më cilësore dhe vetëm me një rini të shëndoshë, të edukuar dhe të arsimuar do të kemi një shoqëri të mirë dhe një shtet stabil e demokratik në rajon . Se fundja nuk thuhej kot se ardhmja e një kombi të një shteti është rinia e ne fatbardhësisht kemi rini të mrekullueshme: Ju falemnderit.

NEXHAT DACI

Ju lutem do të mundohem me iu dhanë fjalën vetëm atyre që kanë dhanë në fillim, prandaj edhe sot një tolerancë do të jap të gjithëve fjalën. Nuk është mirë që një fjalë ta inicojë mendimin e të tjetrit, pro ose po, ne po flasim për ligjin në rend të ditës.

BLERIM BARUTI LDK

I nderuar kryeparlamentar, të nderuar ministra,

Më lejoni që me disa fjalë që sot po diskutojmë rreth një ligji shumë të rëndësishëm për shkollimin dhe edukimin e gjeneratave të ardhshme. Mendoj se ligji duhet përkrahur me sygjerime dhe vërejtje kualitative të paraqitura, sepse është një bazë e cila hapë dyertë drejtë integrimeve të shkollimit sipas modeleve perendimore.
Fundja qëllimi i reformës është të shkohet me një kualitet të ri në këtë segment posaçërisht sygjeroj që të ndihmoni në organet gjegjëse në përpilimin e strategjive për mbajtjen e procesit mësimor në komunën e Mitrovicës. Shqetësuese sot është paraqitja e Universitetit të pjesësë veriore. Këtu konsideroj se është vetëm një Universitet i Prishtinës, pa ndarjen e bazave etnike, nga se universiteti i ashtuquajtur i pjesësë veriore mësimin e mbanë në institucionin e Fakultetit Xehtaro - Metalurgjik dhe të Shkollës së Lartë Teknike, ndërsa studentët shqiptarë të Fakultetit Xehtaro - Metalurgjik dhe të Shkollës së Lartë Teknike, janë të detyruar procesin ta zhvillojnë në lokalet e shkollës

fillore "Eqrem Çabej" dhe shkollës fillore "Skenderbeu" me improvizimin brenda mundësive të cilat i kanë.

Po ju lus se ku e kemi të drejtën e natyrshme q ë të punojnë punën tonë hulumtuese kërkimore e shkencore në laboratoret, kabinetet, amfiteatret, mësimtoret konviktet, menzet dhe mjediset tjera përcjellëse, lokalet e të cilave janë të ndërtuara në territorin e Kosovës dhe me ndjersën dhe punën e kosovarëve. Ju falemnderit.

BAJRAM KOSUMI

Të nderuar deputetë, të nderuar ministra të Qeverisë të Kosovës,

Nuk ka dyshim se projektligji për arsimin e lartë është i një niveli të mirë. Janë të renditura pjesët mirë, paragrafet dhe çështjet themelore, mirëpo në mënyrë të njejtë mendoj për projektligjin për arsimin fillor dhe të mesëm, mirëpo mendoj në të dy projektligjet mungon diçka, mungon që nuk mundet thjeshtë të përfshihet në paragraf. Mungon një vizion se çka të bëjmë me mijëra nxënës që shkojnë në shkollat e mesme dhe i kryejnë shkollat e mesme dhe çka të bëjmë me mijëra studentë që shkojnë në fakultete dhe i kryejnë fakultetet kështu qysh është në këto dy projektligje, po i përmendi të dyja, sepse lidhet kjo çështje me të dyjat po diskutoj për arsimin e lartë, do të vazhdojë e njejta formë qysh është tash, e forma që është tash nxënësit që e kryejnë shkollën fillore nuk mund të punësohet, e ka shkolllimin e mesëm falas shkon në shkollë sa për ta humbur kohën, d he k ur t a k ryen s hkollën e m esme a i n uk p rofesionalizohet n ë a snjë d rejtim, kryen një shkollë të mesme cila do qoftë ajo, nga ato që ne i kemi në Kosovë, e ai kur ta kryen shkollën e mesme nuk është i zoti ta kryej asnjë punë, dhe si zgjidhje kërkon me shku në fakultet përsëri, sepse nuk mundet me kry asnjë punë me shkollën e mesme, dhe shkon dhe krejt tendenca, pastaj shkojnë me mijëra në fakultet. Ndoshta në Kosovë nuk ka vende të punës për të gjithë ata ndërsa ne ende nuk kemi aritur një standard të tillë për me qu ata me punue në Berlin, Londër e në vendet tjera. Prandaj duhet të mendojë Qeveria, duhet të mendoj dhe ju kisha thirrur edhe juve, sidomos komisionet që do të miren më detajisht me këto dy projektligje të mendojnë pak për këtë vizion, çka do të bëjmë me numrin aq të madh të nxënësve si do t'i shkollojmë dhe çka do të bëjmë me ta

pasi ta kryejnë shkollën. Prandaj unë mendoj se ndoshta një zgjidhje e mundëshme do të ishte me ndrrue disa baza në kriterin e finansimit të shkollimit të lartë dhe të atij të mesëm, të profesionalizohen shkollat e mesme dhe të krijohen lehtësira finansiare nxënësve që shkojnë në shkollat që lidhen drejtëpërdrejt me jetën praktike, me prodhimnin, me zanate e tjera, aty të krijojnë pak lehtësira, por nxënësve të shkollave të mesme të particiopojnë në shkollimin e tyre. Shokllimi fillor është i obligueshëm, shkollimi i mesëm nuk është i obligueshëm. Nxënësit duhet të participojnë dhe kjo do ta orientojë nxënësin, mendoj prindëri dhe nxënësi se çfarë shkolla të mesme po shkon dhe të mendojë se çka ka me u ba kur ta kryej shkollën e mesme në arsimin e lartë. Mendoj se po ashtu duhet të ndrrohet shumë kriteri, parimet bazë të finansimit dhe të studentët të bartin një pjesë të madhe të finansimit, ndërsa Qeveria të subvensionojë arsimin e lartë, ndihmojnë në strehimin e tyre në konviktet, ndihmojnë në ushqim në çështje tjera, por edhe studentët ta marrin një barë mbi vete, t'ju duket pak e rëndë për shkak kushteve të vështira në Kosovë, por lehtë është me thanë t'i shkollojmë. Nuk di sa është shifra e shkollarëve të mesëm, po do të kemi problem mbas 5 viteve, 10 viteve ata shkollarë të mesëm dhe ata njerëz me diplom nuk do të dijmë ku me i çu, do të mbesim me diplomë rrugëve k anë m e m betur, m a m irë ë shtë m e o rientu, m e s hku n ë s hkolla p rofesionale, sepse me leju këtë stihi që ka qenë deri tash, Ju falemnderit.

NIMON ALIMUSAJ

E nderuara Kryesi, të nderuar ministëra, të nderuar delegatë,

Unë jam anëtar i Komisionit për arsim, shkencë dhe tekonolgji dhe vërejtjet tona i kemi dhanë, i kemi paraqitur përpara, prandaj nuk do të ndalem në këtë. Unë do të trajtoj dy çështje.

E përmendi z. ministër procedurën e këtij projektligji. Unë do të shtoja diçka; U tha se këto ligje i ka hartuar Këshilli i Evropës, dhe atëherë është paraparë se këto ligje të miratohen para zgjedhjeve, dhe këtu po del një problem shumë substancial, është stopu, dmth nuk janë miratu këto ligje para zgjedhjeve nga z. Hakerup, më vonë është theksuar dhe është konsideruar se do të ishte citojë nga një udhëzues :''se do të ishte shumë më

pak problematike në mënyrë supstantive dhe procedurale nëse do të hynin në fuqi këto ligje do të hynin në fuqi para se të themelohej Kuvendi i Kosovës. Ka ndodhë më duket, dy tri ditë para se të themelohej Kuvendi kanë ardhur në fuqi këto, e disa orë para se të vinte z. Shtajner është nënshkruar në vendin e tij dikush tjetër.Krejt kjo ecuri kështu tregon se si e tha njeri nga parafolësit se nuk ka qenë transparenca e duhur dhe ka sjell disa probleme dhe po e përsëris që ka qenë shumë substanciale. Nuk është fjala këtu te verzioni anglisht siç na shkruhet te materialet që i bini ju, shikoni versioni angleze me u mbizotërua, kështu shkruan. Unë kujtoj se versioni anglez do të duhej të mirrej në konsideratë që të shihej origjinaliteti i teksteve në të tri gjuhët e jo të ketë përmbajtje krejtë tjera. Kështu psh. në versionin anglez nuk është fjala për një fjali si e dha ajo zonja më parë, por është fjala për një nen të tërë është në faqen 9. Ju sigurisht i keni këto projektligje, është fjala për nenin 10.7, i cili nuk ekziston fare në verzionin shqip, ai flet për Universitetin e Mitrovicës veriore, dhe po të shikohet udhëzuesi atje ka do kompetenca rektori, prorektori që i bien ndesh edhe vetë projektligjit që e kemi në versionin shqip, prandaj do të kërkoja që më parë të sqarohen këto punë, përndryshe nuk është fjala për një ligjë të vetëm, por ka ndryshime shumë kardinale, flitet për dy universitete që i bien ndesh me normativ njëri tjetrit.

NEXHAT DACI

Unë shpresoj që në fillim u kuptuam që ligji do të vjen në gjuhën punuese të Qeverisë do të procedohet në gjuhën punuese të Parlamentit dhe to të shkruhet në atë gjuhë në të cilën është procedu, dhe ju lutem kemi pasur mjaft zbrazësi emocioneve politike nga të gjitha grupacionet, në ligjin e ardhshëm do të përqëndrohemi vërtetë në substancën të cilën e kemi në rend të ditës.

SALA AHMETAJ

I nderuari kryetar, e nderuara Kryesi, të nderuar kolegë deputetë,

Unë kam përgatitur një tekst. E kam shikuar me shumë vemendje projektligjin për arsimin e lartë dhe këtu kam dhënë shqetësimet e mia. Të debatosh për reformën dhe ligjin për arsimin e lartë, kërkohet përgjegjësi, përkushtim dhe maturi edhe për arsye se arsimi në Kosovë identifikohet me idealet më të larta kombëtare, mjerisht kjo është shtresa më e përbuzur dhe më e shpërfillur. Për bërjen e një reforme gjithëpërfshirëse dhe përbajtësore të sistemit arsimor aktualisht ka edhe vështirësi objektive,

1. Statusi politik i pa zgjidhur i Kosovës,
2. Baza materiale finansiare e arsimit,
3. Infrastruktura e pamjaftueshme dhe
4. Tranzicioni si proces.

Përveç vërejtjetve tjera unë do të flasë edhe për një sintagëm, vërejtja jonë për sintagëmën reformë sipas modelit të sistemit arsimor evropianë është
Në botën evro-perendimore nuk ekziston një model unik i sistemit arsimor edhe në vendet me sistem të dencetralizuar ka dallime të mëdha. Në Angli, për shembull, ekzistojnë 5 nivele të universitetesh, secili universitet evropian ka specifikat dhe veçoritë e veta, qofshin ato të qytetit apo shtetit që i përkasin. Universiteti i Prishtinës nuk mund të krahasohet prandaj me asnjë universitet dhe nuk mund të jetë asnjërit prej tyre. Së pari ky është universiteti i vetëm i Kosovës dhe duhet të jetë në shërbim të mjedisit që i takon dhe gjithënjë duke qenë i hapur për të përfillur edhe përvojat e të tjerëve.
Natyra e universitetit është edhe arsimore edhe shkencore. Këto vlera duhet t'i ruajë dhe kultivojë universiteti ynë, sepse ka edhe përpjekje për të zhveshur universitetin nga akademizmi, për të ruajtur karakterin akademik. Për të qenë i aftë të prodhojë rezultate dhe vlera të pranueshme edhe për shoqërinë kosovare edhe për ate evropiane e më gjërë, ne do ta parapëlqenim skenën 4 ose 5 duke mos llogaritur studimet posuniversitare. Degët gjuhë dhe letërsi shqipe dhe letërsi e gjuhë shqipe të Fakultetit të Filologjisë e kanë ruajtur këtë skemë, që ta ruajmë akademizmin ky duhet të jetë synimi dhe qëllimi i universitetit tonë, për të aritur këtë dhe që të mos shpërfillen synimet që kemi, përveç tjerash duhet të kemi edhe infrastrukturë ligjore të qëlluar.

Për projektligjin e propozuar për arsimin e lartë kemi disa vërejtje parimore të vështruara në disa rafshe.

1. Në planin përbajtësor,
2. Rreth terminologjisë,
3. Në atë gjuhësor,

Me ligj nuk do të duhej të cenohej liria akademike dhe liria e universitetit. Na duket se ministrisë i janë dhënë kompetenca të gjëra, këtu kam shënuar edhe vërejtjet konkrete.

Pika 4 , domethënë pjesa 4 1 b, pas tekstit e kzistues të shtohet: statutet miratohen në Kuvend; pika 4 1 e togfjalëshi: marrja e masave të bëhet: mirret vendimi ose marrja e vendimit; pika 4. 6 te fjalia ndër ta janë të paktën 3 personal; ju lutem ndryshe është kur thuhet 3 e ndryshe të paktën 3, do të thotë të paktën 3 mund të thuhet 10 ose 15 e tjerë.

Ekspertë ndërkombëtarë, unë kërkoj të precizohet numri 2 ose 3 jo më shumë, dhe fjalia e fundit që fillon, asnjë vendim të ndryshohet dhe propozoj që: si vijon aktvendimet apo rekomandimet i merr me miratimin e shumicës së anëtarëve.

Pika 5 .1.pjesa pas lidhëzës dhe të saktësohet: cilat janë institucionet tjera të arsimit të lartë .

Pika 5. 4. pas fjalisë së fundit të shtohet: pas miratimit në Kuvend ;

Pika 5.2. pas fjalisë së parë të shtohet; edhe miratimi në Kuvend;

Pjesa 12. pika 12.4 duket konfuze dhe është në kundërshtim me pjesën 7 pika 7.2. d dhe e.

Pjesa 14 , pika 14 5 b togëfjalëshi; nga një mjek i pavarur të ndryshohet; që të bëhet nga një komision mjekësor i pavarur;

Pjesa 1 8, pika 1 8.1 fjalia e fundit të ndryshohet, pika 1 8.2 d është në kundërshim me pjesën 16. pika 16.1. reth termonologjis, Në vend të fjalës: trajnim propozoj fjalën "aftësim", dhe në vend të fjalës "guvernator drejtues, ja se ç'shkruan në fjalorin e gjuhës shqipe për fjalën guvernator përveç tjerash; Është zyrtari më i lartë që përfaqëson shtetin sundues në një koloni''.

Kurse për fjalën për ''termin'' trajnim kujtoj se do ta zbehte dhe do ta lëndonte konceptin e akademizmit, kjo do të nënkuptonte, tkurrje, rrudhje, ngushtim apo kufizim në hulumtim. Trajnim do të thotë arsimim, stërvitje varësisht nga fushat në të cilën ai përdoret. Në këtë rast unë propozoj fjalën ''aftësim''. Për gabimet gjuhësore nuk do të

flasë, ka shumë sikur në gjitha tekstet tjera që na vijnë, shqetësimet u thanë edhe nga folësit tjerë. Shpesoj se Kuvendi i Kosovës dhe ministritë tona më në fund do të marrin lektorë ekspertë të mirëfillët të shqipes për këtë punë, të mos flasim më në Kuvend.

FADIL KRYEZIU

I nderuari kryetar, të nderuar deputet dhe ministra,

Unë do të provojë, do të jemë shumë i shkurtër edhe ashtu nga natyra jam i shkurtë, por do të flasë dy fjalë në raport me ligjin për arsimin e lartë do të thotë;
Që dashuria për shkollën dhe dashuri ndaj sajë së fundi është edhe virtyt karakteristik i popullitë tonë, është një karakteristikë që ne e përjetojmë përditë, por është një karakteristikë me të cilën pra ose vërtetë miqët tanë që vijnë nga jashtë hasin në ndër vlerat e para të këtij populli. Prandaj këte nuk duhet ta harojmë asnjëherë, se për mua është një emocion i veçantë sot kur diskutohet për ligjin për arsimin e lartë dhe sigurisht për ate fillor dhe të mesëm.
Në dispozitat e këtij ligji, pjesa e dytë dmth. pika 2 .3 në rastin e paraqitjes për vlerësëim të një diplome të huaj, pjekurie mendoj se deri vonë si një onstrifikim ashtu e kam kuptuar,thotë me përjashtim të rasteve të veçanta, njohja bëhet vetëm për ertifikata që tregojnë: do të kisha dashur që kjo me përjashtim të rasteve të veçanta të specifikohet për cilat raste bëhet fjalë, për arsye se rasti i veçantë do të jetë ndonjë nxënës i suksesshëm kualitativ që mund `të ecë përpara para gjeneratës të tij, por një rast i veçantë mund të jetë edhe djali i tezes, dajës hallës e tjera.
Në rastet tjera nuk e kam ose duhet të jetë fjalia 2.6 e pa strukturuarr mirë. Subjektet e licensuara në bazë të këtij ligji nuk mund të kufizohen. Kështu shkruan në udhëzimet e administrative të nxjera mbi bazën e tij në dispozitat e ndonjë ligji tjetër nuk u kufizohet liria në veprimtarinë e tyre. Mendoj që lektori ka punë këtu që ta ristrikturojë këtë fjali që të jetë në ristruktim të plotë. Në anën tjetër në pjesën 6 është paragrafi 6. 2 nuk do të ndalem gjatë, por edhe këtu do të theksoj diçka që mendoj që edhe ne ballafaqohemi gjatë këtyre ditëve në lokalitetet tona dhe me shkollat e larta pedagogjike.

Institucionet publike 6.1 pra aty pash komisioni për arsim, shkencë dhe teknologji. Këtij Parlamenti i ka dhënë vërejtje adekvate.

Do të kalojë në pikën 6. 2 ku thuhet: nëse Ministria mendon se është në interesin e përgjithëshëm atëherë a jo mund të shkrijë ose mbyll institucionet publike të arsimit të lartë. Unë mendoj që Ministria dhe Qeveria është organ ekzekutiv, pra është pushtet ekzekutiv dhe Qeveria duhet të konstatojë, duhet të konkludojë pas elaborimeve, pas studimeve, pas hululmtimeve, por nuk është thanun vetëm të mendoj, sepse mbas këtij qëndrimi Ministria mendon se është në interesin e përgjithshëm, ne jemi ballafaqu sigurisht mund të ketë menduar rektorati i Universitetit të Prishtinës duke mos shpallur konkursin për shkollat e larta pedagogjike në Kosovë. Në kohën kur nuk ka vendim për anulimin e dispozitave paraprake me të cilat edhe këtu është shkollat të larta pedagogjike janë përfëshirë në riorganizimin në bazë të deklaratës së Bolonjës, pra kanë kaluar në shkallë të tretë të studimit, madje edhe një gjeneratë është pranuar, por nuk ka dokument të hapur që precizohet edhe në ligj në këtë projektpropozim, i cili duhet të diskutohet, duhet të shqyrtohet në një debat të h apur dhe nuk ka a s k onsultime mes strukturave drejtuese të këtyre institucioneve. Unë mendoj që mirë është Universiteti i Prishtinës është një nga universitetet më të begatuara, me shumë lëmij studimi, por nuk reflekton krejtë mirë në qoftë se çdo gjë koncentrohet në Prishtinë, do të doja të thoja edhe këte, yndyra e intelektualëve kosovarë mund të jetë në Prishtinë, por nuk do të thotë që krejt intelektualët kosovarë janë në Prishtinë. Prandaj, nuk është e drejtë që ne t'u marrim të drejtën, ju do ta kontestoni kur është fjala t'ia marrim të drejtën 300 studentëve në vitin e parë në një shkollë të lartë të pedagogjike kjo Shkollë e Lartë Pedagogjike në Prizren , por në fakt ua vështirëson të drejtën e studimit të tyre në qoftëse nuk u mungojnë në këto qendra, vetëm edhe këtë vërejtje e kam, thuhet se në universitet dmth. për tu akredituar, për një universitet të ri e kam fjalën, duhet të ketë më së paku numrin prej 3000 studentëve të ditës ndërkaç mendoj që është një numër shifër e lartë kjo shifër mund të rishqyrtohet dhe diskutohet edhe në shqyrtimin e ...

GJEVDET NEZIRAJ

I nderuar z. kryetarë, të nderuar zotërinj ministra, deputetë dhe deputete,

Unë nuk do të bisedoj atë çka është bisedu, por do të ndalem në pikën e regjistrimit dhe studentëve të drejtat komuniteteve të tyre do të kisha me cekë këtu të drejtën për komunitetin egjiptas pasi që është në një pozitë specifike pasi që gjuhën amëtare e ka gjuhën shqipe dhe në regjistrim me studentët jemi në një konkurencë edhe kuantitative edhe kualitative shumë të madhe dhe kështu me minoritetet tjera jemi në një pozitë shumë të palakmueshme, për arsye se komuniteti boshnjak goran vetëm mes komunitetit të vetë, komuniteti serbë. Po ashtu unë kisha me dëshiru që të kenë një kohë të caktuar një shtytje pozitive në këtë drejtim në fazën e parë në regjistrimin e një numri shumë të vogël një numri simbolik të studentëve në universitetin e Prishtinës. Edhe ne jemi trajtuar në këto 12 vjeçar shumë vështirë dhe duhet për t'i marë për bazë edhe shumë shkaqe objektive dhe subjektive është duke ngecë një numër shumë i vogël në Univerzitetin e Prishtinës, prandaj nuk do të dëshirojmë që ata studentë gjatë studimeve të jenë të previligjuar të jenë të barabartë me studentët shqiptarë, dhe do të kërkoj që në fillim të kemi një shtytje pozitive në regjistrim fazën e parë.Në këtë vit akademik kanë konkuru 10-15 studentë, mirëpo për një numër shumë i vogël nuk janë regjistruar, prandaj tue pa parasysh se ministria të ketë për bazë dhe ju kam drejtu me një shkresë edhe ministrit edhe kryetarit dr. Rugovës edhe kryeparlamentarit Dacit, por edhe Komisionit të arsimit dhe shkencës z. Kuqi kështu besoj që do të kemi një zgjidhje pozitive. Jam duke kërkuar që të arsimohen dhe të shkollohen në gjuhën shqipe. Unë besoj që me këtë shtytje pozitive do të kemi një çasje dhe integrim shumë më të shpejtë në shoqërinë shqiptare, gjegjësisht kosovare. Ju falemnderit.

NEXHAT DACI,

Është çështje që kërkon seriozitet, prandaj në parim mbështes diskutimin, para se të kalojmë në votim, komisionet duhet të takohen në këto dhoma:

Komisioni për buxhet ose për financa në 17,

Komisioni për të drejtat e komuniteve në 116

Komisioni për edukim shkencë dhe teknologji 114, sipas rregullave pas një debati shumë të frytshëm morën pjesë një numër shumë i madh i deputetëve. Do të votojmë që

ligji në parim mund t'i dërgohet komisioneve dhe për procedurë të mëtejshme. Pyes deputetët kush është për. Lus sekretarin që t'i numërojë votat.
Një abstenon, Xhaviti don zakonisht me u dallu, prandaj shkojmë në pushim 20 minutësh, ju falemdnerti.

GOJKO SAVIĆ KP

Treča tačka dnevnog reda je predstavljanje i čitanje nacrta zakona br. 2002/3 o osnovnom i srednjem obrazovanjem na Kosovo, Ja molilm ministra Rexhepa Osmanija da podnese izlaganje.

REXHEP OSMANI

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë,
Më lejoni të paraqes edhe rezymenë ekzekutive të projektligjeve për arsimin fillor dhe të mesëm. Projektligji për arsimin fillor dhe të mesëm paraqez bazën e nevojshme juridike për një zhvillim të qëndrueshëm për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm. Ky ligj siguron një bazë të mirë për vazhdimin dhe thellimin e reformave në arsim duke synuar standarde evropiane dhe botërore, me qëllim të integrimeve dhe të dijes kosovare me vendet tjera.

- Ky ligj do të zë vendin e legjislacionit të mëparshëm para vitit 1990, pjesërisht dhe rregullorës së arsimit fillor dhe të mesëm të botuara në vitin 1994, të cilat janë përdorur gjatë funksionimit të sistemit të pavarur të arsimit në dekadën e fundit. Po kështu ky ligj zënvendëson rregulloret dhe udhëzimet e administrative të cilat i ka përgatitur armiku në kohën e fundit të bashkëqeverisjes të cilat me shumë segmente të veprimtarisë arsimore zënë vend edhe në projektligjin që do ta shqyrtojmë.
- Ky projektligj është punuar nga një grup i ekpertëve të Këshillit të Europës mbi bazën e një kontrate midis UNMIK-ut dhe Këshillit të Evropës të financuar nga banka botërore.

- Parimet kyqe të këtij projektligji së pari për të drejtat: në këtë projektligj paraqiten qartë të drejtat themelore individuale. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë, pa përjashtim në arsimin e përshtatur për nevojat e tyre, fëmijët me të meta kanë të drejtë për nevoja të posaçme të njihen, prindërit kanë të drejtë të shprehin mendimin se si dhe kur arsimohen fëmijët e tyre dhe në çështjet serioze diciplinore që kanë të bëjnë me fëmijët e tyre. Nxënësit më të vjetër kanë të drejtë të shprehin mendimin për jetën në shkollën e tyre, Pjesëtarët e minioriteteve gjuhësore kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën e tyre amtare. Arsimtarët kanë të drejtë në autonomi profesionale në klasë.
- Të gjithë këta janë përgjegjës për sigurimin e arsimit, arsimtarët, shkollat, komunat, Qeveria duhet të veproj me korrektësi për të gjithë fëmijët dhe prindërit për t'iu shmangur diskriminimit në çfarëdo baze. Detyrat: pjesët plotësuese të këtyre të drejtave janë edhe detyrat që dalin nga këto ligje, prindërit kanë për detyrë se a e ndjekin fëmijët shkollën e tyre. Fëmijët kanë për detyrë të sillen mirë në shkollë duke respektuar të tjerët. Arsimtarët kanë për detyrë të plotësojnë standardet profesionale në punën e tyre.

  Këto të drejta dhe detyra do të jenë të zbatueshme në ligjë nëpërmes të gjykatësve të Kosovës. Projektligji gjithashtu siguron: përmasa diciplilnore për nxënës, masat diciplinore për arsimtarë, mekanizmat e ankesave administartive kundër vendimeve të lëshuara nga shkollat dhe komunat. Me këtë ligj do të jetë një sistem i integruar i shkollës pubike dhe pa pagesë për tërë Kosovën, i cili do të shfrytëzohet nga bashkësitë të ndryshme.
- Arsimi fillor do të jetë i detyrueshëm prej moshës 6 -11 vjeç, përkatësisht që nga klasa e parë deri në të pestën dhe nga klasa e gjashtë deri në të nëntën. Arsimi i mesëm i ultë gjithashtu është i detyrueshëm. Është fjala për moshën që përmenda, tani do të vazhdojë deri në moshën 15 vjeçare, që nga klasa e 6 deri në klasën e 9-të. Arsimi i mesëm i lartë deri në moshën 18 vjeçare duhet të jetë përgjegjës nga klasa e 10 deri në klasën e 12 ose në klasën 13.
- Arsimi për fëmijët me nevoja të posaqme siç janë ata me paaftësi aq sa të jetë e mundur do t'i vijojnë shkollat e zakonshme me mbështetje nga mjetet e specializuara. Shkollat e të gjitha niveleve duhet t'i pregatisin qytetarët e

ardhshëm të Kosovës për të gjitha aspektet e jetës së të rriturve në bashkëpunim me familjen. A ta duhet të përcjellin vlerat e shëndosha morale dhe trashigimin kulturor të bashkësive të tyre, të nxisin zhvilllimin e personalitetit individual dhe t'i pajisin fëmijët me shkathtësi të nevojshme për të fituar për jetesën e tyre si të rritur në botën e tyre konkuruese.

Skema për organizimin e arsimit përpiqet të zhvillon sistemin shkollor miraton programet mësimore me dhe pas konsultimeve me palet e interesuara me ekspertët vendore dhe ndërkomtarë dhe organizon vlerësimin e nxënësve. Mbështet aftësimin dhe konfirmon vështirësinë e kualifikimeve të arsimtarëve. Ministria mbikqyr dhe mbështet punën e shkollave dhe të komunave dhe ndanë fondet prej buxhetit qendror sipas kritereve objektive.

Këto organe nuk duhet vepruar në një zbraztësi, pornëpër mjet një dialogu me partnerin kyq siç janë prindërit që do të shprehin pikëpmamjet nëpërmjet këshillave dhe të shkollave të një këshillit të prindërve të fëmijëve të Kosovës.

Kuvendi do të merr një raport vjetor nga ministri dhe do të kërkoj nga ai që të jep një llogari për punën e Ministrisë dhe të funksionimit të sistemit shkollor në Kosovë.

Ndërsa, përfaqsuesi special do të mbajë një mbikqyrje mbi bazën e Kornizës kushtetuese dhe në përgjegjësi të posaçme mbi të drejtat e bashkësive për pikën 4 të Kornizës kushtetuese. Ju falemnderit.

Zahvaljujem ministru Rexhepa Osmanija, ja sada bi zvao ministra za obrazovanje, nije tu, ja se izvinjavam.

(nuk e di emrin e deputetes)

E nderuara Kryesi, të nderuar ministra dhe deputetë,

Unë nuk jam kryetare e këtij komisioni për të cilën u tha tani. Unë jam doktor dhe dëshiroj t'i them disa fjalë, dhe atë meqë jemi në dispozita ligjore për arsimimin fillor dhe të mesëm kam një kërkesë meqense në kuadër të dispozitave ligjore në arsimin fillor dhe të mesëm nuk ishte ceur që në kuadër të këtyre dispozitave të futet edhe një dispozitë e veçantë, që është shumë e rëndësishme për fëmijët tanë dhe

mund ta ceki atë ide që në kuadër të këtyre dispozitave të futet edhe promovimi dhe edukimi shëndetsor si lëndë në këto shkolla, sidomos duke u përfshirë mosha 6-19 vjet.

Me qenëse kemi të shfaqura disa dukuri negative, kemi edhe disa sëmundje ngjitëse që me një edukim dhe një promovim shëndetsor të mirfilltë mund të bëjmë shumë për fëmijët tanë. Ju falemnderit.

Zahvalujem se, da li želi predsednik komisije da zauzme reč.

Ne

NERGJIVANE DAUTI

I nderuari zoti kryesues, të nderuar deputetë,

Diskutimin tim do ta përqëndroj në frymën e ligjit që është objekt diskutimi në agjentën e sotme:

1. Së pari para se të paraqes komentën – projektlilgjin për arsimin fillor dhe të mesëm të Kosovës për hirë të rregullimit juridik të kësaj çështje me interes shumë të madh është me rëndësi të theksoj që për herë të parë në Kosovë programi i arsimit parashkollor, fillor dhe i mesëm organizohet sipas nivelit të ISCEDI-t apo klasifikimi i standardeve ndërkomtare të arsimit 1997 i miratuar nga konferenca e përgjithshme e UNESKOS në sesionin 29 të saj në nëntor të vitit 1997.
2. Projektligji për arsimin fillor dhe të mesëm i Kosovës për nga aspekti i rëndësisë së ekzistimit të implementimit të tij është shumë i nevojshëm në drejtim të plotësimit të zbraztësirave juridike, duke siguruar kështu sistem solid për fushën e arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë.
3. Së treti: Projektligji në fjalë në esencë paraqet standarde të larta evropiane duke krijuar në këtë mënyrë një shteg të zhvillimit të ardhshëm demokratik arsimor të Kosovës dhe njëkohësisht duhet të sigurojë baza më të mira për reformat e ardhshme të Kosovës.
4. Së katërti: Marrë në tërësi mendoj se po të revidoheshin, të mënjanoheshin disa dispozita juridike dhe të përmirsoheshin gabimet gjuhësore, projektligji do të

plotësonte kushtet e një ligji shumë të mirë, megjithatë asnjë legjislaturë nuk është e përkryer dhe definitive. Kushtet e ndryshueshme sigurisht se do të kërkojnë legjislacione, të ndryshuara në drejtime të nevojshme. Në vazhdim të diskutimit tim do të vazhdoj me vërejtjet e veçanta që kanë të bëjnë me këtë projektligj.

Neni 5.2 të riformulohet si vijon:E drejta për arsim special të nxënësve me vështirësi apo ngecja në të mësuar trajtohet apo shqyrtohet në kapitullin e 7 të këtij ligji.

Neni 7.2 është i paqartë dhe i mangët.

Neni 7.10 të riformulohet si vijon: prindi, prindërit e një nxënësi që jetojnë jashtë zonës së mbulimit të një institucioni arsimor mund të kërkojë nga komuna përkatëse ta regjistrojë nxënësin në këtë institucion. Këto vende caktohen nga komuna në mënyrë të drejtë në bazë të kritereve transparente që shpallen publikisht.

Neni 7.13 është i paqartë Propozoj që të paraqiten disa arsye apo shkaqe për të cilat komuna mund të jep leje për shkëputje nga shkolla deri në 2 javë.

Në Nenin 7.15 është cekur se në qoftë se një nxënës mungon në procesin e arsimit të detyruar prindi apo prindërit e tij apo të saj mund të detyrohen të paguajnë gjobë në qoftë se mungesa është rezultat i veprimeve të qëllimshme apo neglizhencës së prindit apo prindërve. Në raste të tilla komuna njofton ministrin e arsimit, shkencës dhe teknologjisë dhe ndëshkimet maksimale do të përcaktohen në përputhje me ligjin përkatës. Rastet e mungesës së paarsyeshme të nxënësit nga procesi edukativo-mësimor pa dyshim që krijojnë veprime të inkriminuara, mirëpo shtrohet pyetja: veprime të tilla a mund të trajtohen apriori kriminale apo penale sikurse rezulton nga neni 7.15 i projektligjit.

Neni 8.2 të riformulohet si vijon, pranimi në arsimin e mesëm të lartë bëhet në bazë të një sistemi të drejtë për zgjedhjet e administruara nga komunat në përputhje me konkluzionet me anë të organit kompetent komunal që duhet të ishte i autorizuar për administrim të edukimit në juridikasionin komunal.

Neni 8.3, është i pakuptueshëm në pjesë. Në ndërmarrje private apo publike, ndërkaq termi edukim të interpretohet në kupitullin e definimeve konceptuale të projektligjit.

Neni 9.1 të plotësohet me moralin shoqëror.

Neni 9.3, sygjerohet të riformulohet me sa vijon: Të përcaktohet saktë organi komunal i cili siguron shqyrtimin me objektivitet të këtyre ankesave.

Neni 9.4 i projektligjit duhet plotësuar me një aline, të adresohet ai konkretizim me aktin juridik siç mund të jetë instrukcioni apo udhëzimi etj.

Formulimi i nenit 10.4 duhet të jetë: Ministria e Arsimit, Shkencës, Tekonologjisë paraqet në Kuvend raportin vjetor lidhur me arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë. Në vazhdim ky nen të plotësohet edhe me sa vijon, kërkon nga shkollat të dhënat e caktuara për nevojat zyrtare, jep instrukcione detyrimore konform me ligjin që i referohen çështjeve organizative dhe funksionale të instutucioneve të eduktimit fillor dhe të mesëm.

Në nenin 10.5 të precizohet ligji,

Në nenin 3.2 formulimi, madhësia maksimale në klasë të fshihet. Propozoj të formulohet si numri maksimal të nxënësve në klasë.

Neni 13.3 të riformulohet si vijon. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë bënë kontrollimin periodik të institucioneve arsimore dhe jep rekomandime për përmirësim. Në rast se konstaton gjendjen që përbën shkelje të këtij ligji, ose udhëzimeve të nxjerrura në bazë të tij Ministria e Arsimit mund të udhëzojë korrigjimin e kësaj gjendjeje.

Neni 13.5 nën A sygjerohet formulimi në mënyrën vijuese, Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë emëron, punëson dhe shkarkon një drejtor në çdo shkollë, komunale në bazë të rekomandimit të komisionit të përbashkët të përfaqësuesve të Ministrisë të Arsimit dhe komunës i cili formohet me udhëzimin paraprak të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Neni 16.2 propozoj që në vend të formulimit funksioni i KPAK të zëvendsohet me: funksioni i Komitetit kosovar prindor për arsim, KKPA. Autorizimi nga dispozitat ligjore të nenin 20.1 të projektligjit më parë do të ishte ingjirencë e Ministrisë së Arsimit apo ispeksionit arsimor sesa e komunës. Komuna përveç autorizimeve të tjera e ka edhe këtë që e theksuam, por si ato edhe këtë ajo i ushtron nëpërmjet organeve komunale kompetente.

Formulimi i nenit 22.1 duhet të jetë: komuna organizon transport të sigurtë dhe të efektshëm për frekuentimin e shkollave për nxënësit e jo nga nxënësit e arsimit siç ekziston në këtë projektligj.

Në nenin 24.2 duhet të precizohet afati i kohëzgjatjes së mandatit të personit të emruar si drejtor, është zgjidhje në praktikë që mandati i drejtorit të precizohet në këtë ligj, në vend se ai të cedohet në funksion të akteve juridike të institucionit arsimor, drejtori mund të shkarkohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjis sipas nenit 24.4 nën A, në rast se është dënuar nga gjykata si fajtor për krime serioze penale. Në ligj propozoj që të precizohet saktë se cili është ai akt serioz, sepse në praktikë do të paraqiteshin interpretime të llojllojshme e në të shumtën e rasteve edhe në dëm të parimit legalitetit në konstelacion në formimin e bërë në këtë projektligj.

Neni 27 thuhet: njohtimin publik le të zëvendësohet me konurs.

Neni 29.11 nën A: zhvillimi fizik të shkollës formulimi i tillë nuk është i qartë.

Në nenin 31.4 shkelje serioze të rregullave, duhet të precizohen së paku ato më të rëndësishmet.

Në nenin 32.4, theksohet të gjitha vendet e lira reklamohen, ky nen të riformulohet si të gjitha vendet e lira të punës të shpallen publikisht ndërkaq, termi komuna të precizohet në organin kompetent të saj në publikim të shpalljeve, përkatësisht të shpalljeve, përkatësisht të konkurseve publike.

Neni 33.2, kësaj dispozite juridike t'i shtohet në rastet e përcaktuara decidivisht me ligj.

Në nenin 41.6 jo për të paktën, por për tri vite.

Neni 45 të riformulohet konform me institutin juridik "vakats jo lejdiz". Ju falenderoj për vëmendje, vërejtjet e mia do t'i prezentoj edhe me shkrim.

Zahvalujem se, reč ima

SMILKA MILOSAVLJEVIĆ

Gospodo poslanici,

Komisije za obrazovanje nauku tehnologiju gde sam učestvovala u radu i na Nacrt zakona o osnovnom i srednjem obrazovanju dala sam svoje primedbe. Međutim,

žalim i moram da konstatujem sa žaljenjem danas da u zapisniku moje primedbe uopšte nisu naznačene, niti su važne niti su jednostavno zapisane. Iz istog razloga javljam se za diskusiju i iznosim svoje ocene o Nacrtu zakona o osnovnom i srednjem obrazovanju . Generalno, Zakon predstavlja napor, znači doprinos da se podnigne obrazovni nivo osnovnog i srednjeh obrazovanja za sve zajednice na Kosovu i Metohiji.Medjutim, moja osnovna primedba je bila da prilikom donošenja Nacrta zakona nisu na adekvatan način uvaženi interesi etničkih zajednica, odnosno u skladu sa podgljavljem 3 i pdglavljem 4. Ustavnog okvira, odnosno posebno u skladu sa zajednikim sporzumom UNMIK-a , S.R. Jugoslavija koja se odnosi na srpsku zajrednicu. Zbog toga imam predlog, da u Nacrt zakona bude član koji se odnosi na etničke zajednice i da u tom članu bude definisano da sve etničke zajednice imaju pravo obrazovanja na svom jeziku da sve etničke zajednice imaju pravo uključivanja u sve sfere tekućeg procesa reforme obrazovanja kao i na obuhvatanju njihovih interesa u reformi i nastavnih planova i programa, zatim da proces reforme obrazovanja za srpsku zajednicu treba da bude sinhorizovan za tekućim procesom reforme u Srbiji. U pogledu srpskih zajednica reforma nastavnog plana i programa treba da obezbedi kompatibilnost sa sistemom obrazovanja u Srbiji u pogledu upisa učenioka trajanje školovanja, samih obrazovanih sadržaja sistema stručnih sprema sposobnosti i direktno priznavanje godinu za godinu u toku školovanja u osnovnom i srednjem obrazovanju. Do povratka raseljenih pri finansiranju moraju biti uvažene posledice preseljenja od mreže škola veličina odeljenja, norme časova i ukupnog broja zaposlenih Direktora škole za srpsku zajednicu bira školski odbor na osnovu javnog konkursa po pribavljenjom mišljenje nastavnog veća školskih odbora trećinu članova iz lokalne samouprave i trećinu iz sastava nastavničkog veća i trećinu iz saveta roditelja. Moram da naglasim da je obrazovanje, pogotovo osnovno i srednje od esencijalnog značaja za srpsku zajednicu po pitanju njenog vraćanja i opstanka, jer je veliki deo nše populacije raseljenju i istog razloga mora obezbediti kompativbilnost za obilni sistem za našu zajednicu – Hvala

FATMIR REXHEPI

Zonja dhe zotërinjë deputetë,

Sa i përket arsimit të lartë Ministria menjëherë pas marrjes së detyrës diku me 5 ose 6 mars ka marr një dokument nga ish- bashkadrejtuesi i Departamentit të Shkencës dhe Teknologjis, një dokument i cili është nënshtruar nga zëvendës përfaqësuesi special me 14 shkurt më të cilën legjitimon një universitet, një institucion të arsimit të lartë në Mitrovicë, dhe emërton me emrin universiteti verior i Kosovës. Sipas këtij dokumenti – dokumenti përbëhet nga 4 pjesë: pjesa e parë ka të bëjë me disa dispozita të përgjithshme në të cilën na kreditohet ky institicuon i arsimit të lartë dhe emërtohet. Pjesa e dytë ka të bëjë me zgjedhjen e strukturave në universitet, ku flitet për zgjedhjen e rektorit të universitetit në të cilën jepen kompetenca Departamentit të Arsimit dhe të Shkencës ose pasardhësit t ë t ij q ë n ë këtë r ast është M inistria e A rsimit, S hkencës d he T eknologjis. Ministria e Arsimit nuk ka pasur çasje për emërtimin e rektorit të ri të Gojko Saviqit për rektor të universitetit të Kosovës veriore dhe nuk ka pasur çasje për asnji informacion të zhvillimit të këtij universiteti në Mitrovicë.

Sipas disa informacioneve të pjesërishme domëthënë që ka arrit ministri t'i sigurojë atje pritet që të funksionojnë 8 fakultete të këtij universiteti dhe janë zgjedh rektorët dhe planifikohen të regjistrohen diku rreth 1000 studentë, - tani sipas një kërkese që kanë bërë, por me një përmendje të shifrave të numrit të studetëve edhe më tepër.

Mirëpo, ministri nuk ka arrit të konstatoj çfarë është ky progres më tutje i këtij universiteti dhe kur ka filluar, sa studentë ka, kush financon, cilat lokale shfrytëzohen, dhe si është çështja financimi i këtij universiteti, dhe këto informacione ministri nuk ka mund t'i sigurojë. Do të bëjmë përpjekje në të ardhmen të bëjmë një kontakt me përfaqësues të UNMIK-ut, në mënyrë që të kemi një çasje rreth këtij institucioni të arsimit të lartë në Mitrovicë, por me qenëse Ministria nuk ka pas asnjë informacion për te dhe nuk ka informacion për shkallën e zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë, Ministria nuk është pajtuar me tekstin i cili është ka hyrë në dispozitën 10.7 në variantën anglisht se ky universitet sipas asaj dispozite do të konsiderohet i licensuar me afat kohor të pakufizuar, mirëpo mund të licensohet me një afat kohor të pa kufizume, por në kushtet ekzistuese si më 1 mars të vitit 2000. Ministria nuk ka informacion se si kanë qenë kushtet me 1 mars të vitit 2000 për strukturën e këtyre fakulteteve në Mitrovicë. Këto çështje Qeveria e Kosovës e ka shqyrtuar një ditë më parë dje – Qeveria është e mendimit se teksti në gjuhën shqipe duhet të jetë tekst valid dhe nuk merret me çështjet e këtij formulimi në tekstin me variantën anglisht. Sipas kësaj dispozite në qoftëse duhet të jetë objekt, por sipas mendimit tim nuk duhet të jetë objekt për arsye se Ministria nuk ka arrit t ë k etë i nformacionin m inimal r reth k ësaj ç ështje d he n ë r aport m e m inistrin. K y është një institucion paralel i cili funksionon me të gjitha objektivat e një inagurimit të një sistemi paralel të arsimit të lartë në Kosovë. Jo vetm në Mitrovicë, por edhe në komunat tjera të Kosovës: në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Graçanicë.

Dhe për këtë arsye nevojitet një çasje e re dhe një çasje tjetër rreth funksionimit të institucioneve të larta për minoritete, sepse ky univesitet ka emërtim dhe si objektiv e ka zhvillimin institucionin e lartë për gjuhët sllave kështu domëthanë jipet përmbajtja e punës të këtij universiteti prandaj, këtu është e dhe një çështje diskutabile, ka edhe një çështje tjetër dhe Ministria nuk ka mundur të meret me punë politike të këtij institucioni të lartë, sepse konsideron se ka. Themelimi i këtij universiteti ka prapaskenë politike që Ministria nuk ka mundur të hyjë.Unë kam hy vetëm në çështjet administrative dhe në një çështje dhe në informacionet i cili ka mundur ministri t'i sigurojë.

Qështja tjetër që dua ta përmendi dhe që u përmend edhe ma tutje, çështja e refleksionit të dispozitave të ligjit mbi shkollat e larta pedagogjike në Kosovë,

Këtu dy çështje janë përzi, është përzi çështja e diskutimeve rreth dispozitave ligjore, me të cilat dispozitat ligjore askund nuk përmendet se dje ose sot po e marim një vendim për shuarjen e një institucioni të arsimit të lartë bashkimin e tyre, por ne kemi bisedu parimisht për themelimin bashkimin, integrimin, shuarjen, shpërbërjen e institucioneve të arsimit të lartë që në një rast të caktuar mund të ndodh sipas vlerësimeve edhe që mund të bajë agjensia e akreditimit të Kosovës, i cili është organ që do të ketë përgjegjësinë për matjen e cilësisë në arsimin e lartë.

Dhe pyetjet të cilat janë shtruar kanë të bajnë me tendencën e ruajtjeve të tilla të cilat Ministria ka një revizion tjetër rreth ngritjes së institucionit të një fakulteti të arsimit, i cili fakultet do të merr përgjegjësinë për përgaditjen e kuadrove të reja, të mësuesve të ri, për një shkollë të re në të ardhmen në Kosovë duke shtuar cilësinë e mësimit, duke u marrë me programe të reja, me startin e zgjedhur të mësimdhënësve, dhe duke u marrë me kushtet, pajisjet, objektet në të cilat do të studijojnë, do të mësojnë studentët të cilët do t'i pergadisim për mësues në të ardhmen. Unë mendoj që me këtë tretman të zhvillimit të institucioneve të larta të cilët pregaditen mësues, Ministria e Arsimit nuk ka mundësi të përmisojë cilësinë dhe të ngrisë shkallën e mësimit në shkollat fillore dhe në shkollat e mesme të Kosovës.

Me tepër ka të bëjë me çasje të interesave të cilat janë ngulitur me kohë në shumë institucione të arsimit të lartë dhe ka probleme që të hyjë për freskimin, edhe në kuadrot ka probleme të hyhet edhe me një ndryshim cilësor në kuptim të përgaditjes të këtyre institucioneve që të përgadisin mësues dhe arsimtarë më të mirë për shkollat e Kosovës. E gjithë kjo është bërë transparente me përfaqësuesit e shkollave të larta dhe në të ardhmen pas miratimit t ë ligjit përsëri mbi frymën e dispozitave të ligjit do të vejmë kontaktin me institucionet e tilla, me rektoratin se për këtë qëllim Ministria e Arsimit së bashku me rektoratin do ta ngritur një bord këshillues, i cili deri në momentin e

themelimit të Fakutletit të Edukimit do të ketë përsipër ta përgadisë procesin e zhvillimit të këtij institucioni të ri të Fakultetit të Arsimit.

Një çështje tjetër e cila është theksuar që ka refleksion edhe për opinionin është çështja e miratimit të strukturës të sistemit të arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë.

Është hap i rëndësishëm dhe është hap i madh dhe është hap i nevojshëm që duhet të ndërmiret, sepse për herë të parë ne po bëjmë një thyerje të traditës 8 vjeçare të arsimit fillor dhe të mesëm dhe këtë strukturë Ministria e ka vlerësuar së bashku me ekspertë ndërkomtar, të cilët kanë punuar gjatë këtyre viteve që kanë qenë në Kosovë, me disa korigjime që Ministria ka ndërhyrë në qoftëse e keni vërejtur te struktura 5+4+3 Ministria ka ndërhy ka thënë:5+4+3 ose 4 për profilet arsimore për profilet të cilat mendojmë se nxënësit të cilët duhet të orientojnë në universitet duhet të ndjekin shkollimin e mesëm 4 vjet në gjimnazet dhe gjimnazet teknike për në shkollat të cilat mendojnë se duhet t'i përgadisin nxënësit jo vetëm për krahë pune, jo vetëm për arsimin profesional prodhues, por edhe për dije, edhe për dije teorike, që të vazhdojnë më tutje universitetin dhe shkollimin. Dhe gjatë kësaj faze në arsimin e ulët të mesëm, në të ardhmen do të kenë mundësi që fëmijët të orientohen më herët se sa orientohen tash, më herët se sa që kemi këtë praktikë të endjes të fëmijëve poshtë e lartë, pa një orientim profesional të mirëfilltë, pa informacione të domosdoshme që duhet të kenë fëmijët për orientimin profesional. Atëherë pikërisht kjo është veprim është e krijuar për diskutimet e deputetëve që Ministria tani don të bëjë një thyrje në shkollën e mesme sepse shumë komente dmth. të pakualifikuara jipen edhe në media, sepse po bëhen ndërhyrje në këtë shkollë.

Bëhet ndërhyrja në këtë shkollë se kemi dy sisteme: 9 vjeçare dhe kemi 4 vjeçare dhe sistemi 4 vjeçar është pengesë, sepse shkollën fillore e kemi në stabile dhe ne do të kemi kohë t'i kthehemi shkollës fillore dalëngadalë për ta reformuar atë ndërsa shkollën e mesme do të ndërhyjmë se me mijëra të rrinjë po kryejnë programe arsimore të cilat nuk janë në funksion të jetës, nuk janë në funksion të punës, prandaj për këtë gjeneratë kemi menduar që ta bëjmë këtë thyerje, dhe për këtë arsye dhe kemi propozuar një nen atje, një

dispozitë kalimtare ku do të themi se: kjo skemë do të implementohet plr klasën e 9-të, përkatësisht p ër v itin o rientues k alimtar d uke f illuar n ga v iti s hkollor 2 002/2003. P ër ministrin e arsimit dhe për Ministrinë kanë qenë shumë më lehtë dmth.Nuk ka përgaditje. Ka qenë shumë lehtë dmth. e kemi marrë detyrën shumë vonë. E kemi marrë në gjysëm të këtij gjysmëvjetori, ka qenë shumë lehtë të themi t'i jepim kohë veti, t'i jepim kohë një komunitetit, një takim me komunitetin edhe më tutje, mirëpo kamë konsideruar se ne duhet t'i sfidojmë ndryshimet menjëherë, dhe duhet të hyjmë në ndryshime se procesi i ndryshimeve kërkon vazhdimisht plotësime dhe gjatë këtij procesi ne edhe do ta plotësojmë vetveten duke ecur jo duke pritur, sepse asnjëherë kushtet nuk do të krijonin në atë shkollë, në atë nivel, të ulët ne shpeshherë i realizojmë në vete. Kështu që Ministria ka ndërmarrë hapa të menihershëm për përgaditjet e lokaleve për këtë gjeneratë, ka ndërmarrë masa për a ngazhimin e ekspertëve për sajimin e programeve dhe shumë shpejtë deri me 15 gusht ne do t'i kryejmë punët përfundimtare për fillimin e këtij viti. Këtë po e them edhe për arsye se është e lidhur për një dispozitë të cilën Kuvendi do të vendosë dhe për shkak të informimit të Kuvendit rreth saj dhe të opinionit rreth klasës së 9-të apo vitit orientues që do të themi, sepse programet e vjetra të cilat janë duke u përdorur tash. Sipas analizave të ekspertëve ato programe janë të vjetëruara, janë programe të cilat e kanë kaluar moshën e tyre dhe fondi i orëve të lëndëve të përgjithëshme me lëndë profesionale është i disfavorshëm kështu që ne edhe në shkallën tjera të arsimit profesional akoma kemi lëndë që duhet t'i nxjerrim nga sistemi i arsimit, dhe kjo është arsye për të cilën Ministria ka vendosur që të hyjë dhe është duke i bërë të gjitha përgaditjet, prandaj edhe kërkoj nga Kuvendi që të krijojë hapësirë,mundësi dhe që t'i hapë rrugët Ministrisë edhe mbi bazën juridike që të vazhdojë punën rreth kësaj çështje. Në këtë kuptim do të përfshiheshin minoritetet të cilat poashtu janë thirrë dhe kanë marrë detyrat përkatëse për lëndë shoqërore, edhe gjuhën dhe historinë, nëdrsa për lëndën skema matematikore-natyrore do të jenë dhe lëndë profesionale do të jenë të njejtat me ato që do të përgadisin ekspertët shqiptarë së bashku me nga një përfaqësues të ekspertëve minoritar. Dhe kjo mendoj që kërkon mbështetje dhe Ministria ka nevojë për këtë vizë edhe nga Parlamenti. Çështjet tjera që janë diskutuar jnë edhe disa çështje rreth çështjes së drejtorëve të shkollave, rreth çështjeve të zyrtarëve të lartë, unë mendoj që ne, unë e kuptojë korrektsinë e deputetëve nga partia ime edhe pse ministri është i një

partie. Kërkoj që çështja e drejtorëve të zgjidhet në komuna, mirëpo drejtori i shkollës është një autoritet drejtues, është përgjegjës për cilësinë e mësimit derisa Ministria në sistem dhe makrosistem është përgjegjëse për cilësinë e mësimit, atëherë e kemi zgjedhur variantën e bashkëpunimit të procesit me rastin e propozimit për drejtor dhe në fund ministri vendos , por vendos mbi bazën e konsultimeve nga komunat e deri lartë.Ndërsa, për çështjet tjera janë çështje të cilat i kam një komision dhe komisioni ka dhanë vlerësimet e veta rreth kësaj. Ka qenë edhe një vërejtje për arsimin parashollor të obligueshëm se Kosova vetëm 3% të nxënësve përfshinë në arsimin parashkollor do të thotë këta në çerdhe a na nuk kemi ku t'i fusim nxënësit në qerdhe, prandaj disa çështje praktike me gjithë dëshirën dmth. për të ardhmen që do të bëjë sistemi ynë dhe t'i shtrimë këmbët sa është jorgani si thotë populli dhe hap pas hapi t'i bëjmë këto ndryshime. Ju falemnderit.

NEXHAT DACI

Ju falemnderit z. Ministër. Unë desha t'ju sygjeroj diçka, lëmia e arsimit ka qenë pjesa ose segmenti ma i tanguar nga të gjithë të këqijat që i ka pasur Kosova 10 ose ma shumë vite me radhë. Është krejtësisht e arsyeshme shqetësimi i secilit deputet shqetësimi i opinionit kombëtar në Kosovë se çfarë ligji do të kemi, po ju tërheq vërejtjet se debati për këtë çështje ka përfunduar dje, prandaj debate të veçanta nuk do të ketë, ne sot do të procedojmë sipas rregullave për aprovimin e këtyre ligjeve, do t'ju lutja siç ka qenë në rastin e mëparshëm që çështja kryesore gjatë aprovimit të një ligji do të jetë gjithmonë mendimi i komisionit përkatës dhe atyre komisioneve që e shoqërojnë këtë nismë. Ju themë që për ligjin mbi edukimin superior ka një numër të caktuar të amendamenteve. Komisioni i edukimit shkencës dhe teknologjisë ka bërë 11 sygjerime amendamente, këtu figuron PDG pesë amendamenteve komisioni i komuniteteve 1. Sipas një rregulle që është shpjeguar do të duhete që fjala propozuesve të amendamenteve dhe pasaj do të deklarohet, meqë është një punë velominoze unë do të doja me pajtimin e juaj të kemi këtë çasje,

1. Në seancën e kaluar në shqyrtim ka qenë vetëm verzioni në gjuhën shqipe, për atë verzion për atë pjesë të ligjit që e ka dërguar Qeveria ne sot përcaktohemi, ajo pjesë që nuk ka qenë pjesë e shqyrtimit në Parlament nuk mund të jetë as pjesë e vendimarjes prandaj mos të humbim as kohë as energji për te. Unë do të doja që të ftojë kryesuesin e Komisionit për edukim shkencë dhe teknologji në qoftëse dëshiron të japë mbështetje apo ne kemi me shkrim sygjerimet e atij, prandaj urdhëroni,

NIMON ALIMUSAJ

E nderuara Kryesi, të nderuar delegatë të Kuvendit

Komisioni për arsim shkencë dhe teknologji në dy mbledhjet në të cilat ka qenë prezentë edhe ministri i arsimit ka shqyrtuar nen për nen për arsim fillor të mesëm dhe të lartë dhe ka paraqitur vërejtjet të cilat i keni në dispozicion, dje pas një mbledhjes të Kuvendit ky komision mbajti edhe një mbledhje në të cilën bëri rezymimin e vërejtjeve dhe propozimeve që u dhanë gjatë debatit të mbledhjes së djeshme, edhe në këtë mbledhje mori pjesë edhe minstri z. Rexhep Osmani, Objekti i Komisionit në këtë mbledhje si në dy të tjerat ishte verzioni në gjuhën shqipe dhe të gjitha vërejtjet dhe propozimet i referohen atij verzioni, Komisioni konstatoi se nuk kishte vërejtje dhe propozime që e kontestojnë seriozisht tekstin e projektligjeve. Komisioni e konsideron të pa pranueshëm me ato propozime amendamentesh të cilat synojnë të legjitimojnë sistemin paralel të arsimit të Kosovës.Shumica e vërejtjeve që janë dhanë gjatë debatit të djeshëm përputhen me vërejtjet që ka dhanë Komisioni.

Ndryshimi i disa neneve të propozuara për ndryshim nuk është e mundur, sepse ato ndryshime kushtëzohen edhe ndryshimet e neneve tjera dhe e ndryshojnë krejtë sistemin e këtyre projektligjeve.Komisioni mendon se nuk është mirë të komplikohen këto ligje me shumë gjëra të cilat mund të rregullohen me vendime dhe udhëzime të Ministrisë në të ardhmen, prandaj Komisioni propozon që të miratohen këto projektilgje pasi atyre ju është bërë një lektorim serioz çfarë kërkon edhe serioziteti i ligjeve, Ju falemnderit

NEXHAT DACI

Ju falemdnerit, dy udhëheqës të komisoneve tjera a dëshirojnë të marin pjesë ato që janë të kyçur në këtë ligj urdhëroni, kryetari i komisioneve komuniteteve,

DRAGIŠA KRSTOVIĆ KP

G. Predsedniče, g. ministre dame i gospodo poslanici,

Komisija za prava interesa zajednica juče se sastala posle plenarnog rada Skupštine, i razmotrila je sve primedbe koje su juče date na plenarnom zasedanju. Komisija smatra da predložena rešenja ne ugrožavaju interese nijedne zajednice, prvo amandmani koje je komisija usvojila jednoglasno su prihvaćeni i samo da napomenem da radu komisije nisu prisustvovali pripadnici albanske zajednice.

Inače, komisija, što se tiče Zakona o osnovonm i srednjem obrazovanja stavila je sledeće amandmane. Da se za decu, koja su zbog ratnih okolnosti onemogućena da se redovno obrazuju, obezbedi dodatno obrazovanje naročito za starija godišta i da mlađa godišta budu uključena u redovno školovanje.

Drugo, da učenici manjinjskih zajednica budu okupljeni u što je moguće manjem broju škola, da se izvrši određena koncentracija učenika i nastavnika i to naročito u urbanim sredinama.

Član 3. 1 u nastavku da se doda na svom maternjim jeziku, odnosno albanskom, srpskom bošnjačkom i turskom jeziku,

Član 3. 2, svako dete ima pravo da se obrazuje na svom maternjem jeziku,

Član 4 i 7 da se briše , član 7.6 MONT-je u saradnji sa opštinama je odgovoran za nabavku adekvatnih ućbenika, u nastavku da se doda na maternjem jeziku i čitanka u nastavku da se doda na maternjem jeziku.

7.član 12.4 u nastavku da se doda koja se izdaju na jeziku na kojem učenik pohađa nastavu,

8. član 12. 6 u nastavku da se doda među kojima se obavezo nalazi pojedan iz svakog nastavnog jezika,

9. član 24.7 posle reči direktora dodati i zamenika direktora,

10. 13.5 A da se doda u školama u kojim se nastava odvija na dva ili više jezika zamenik se imenuje iz zajednice različite od zajednice kojoj pripada direktor.

11.član 29.2 S. Da se u školske odbore ne imenjuju deca od 12 do 15 godina, jer su to po našim propisima poslovno nesposobna lica koja i ne verujem da mogu da učestuvju u donošenju značajnih odluka .

Član 30.1.3 u nastavku da se doda školska pravila se objavljuju na svim jezicima na kojim se obavlja nastava u školi. Da se za srednje škole predvidi kvota za manjinske zajednice, naročito kad su u pitanju romska i druge manjinske zajednice.

Da se obezbede uslovi za fakultativne škole u manjinskim zajednicama i ovo naročito važi za romsku zajednicu. Da se primena sistema 5+4+3 odnosno taj takozvani 9 razred odloži do septembra 2003 godine zbog neusklađenosti kosovskog obrazovnog sistema sa obrazovnim sistemima u okruženju.Da se iz poglavlja jedan osnovno odredbe u tački b umesto reči državnu vlast stavi reči PIS-u privremene istitucije samouprave.

Poglavlje 9 lokalne zajednice da se doda ponovo poglavlje 9, a poglavlje 9 će biti pomereno u poglavlje 10 i da se dodaju novi članovi,

Član 42 tačka 1 sve lokalne zajednice imaju pravo obrazovanja na svom jeziku.

Član 42.tačka 2 sve lokalne zajednice imaju pravo uključivanja u sfere tekučih procesa reformi obrazovanja kao i na obuhvatanju njihovih interesa u reformi nastavnih planova i programa.

Član 42.3 proces reformi obrazovanja za srpsku zajednicu treba da bude sinhronizovan sa tekućim procesom reformi u Srbiji,

Član 42.4. u pogledu srpske zajednice reforme nastavnih planova i programa treba da obezbede kompatibilnosti sa sistemom obrazovanja u Srbiji u pogledu upisa učenika, trajanja školovanja, samih ovbrazovnih sadržaja sistema stručne spreme, sposobnost i direktno priznavanje godine za godinu u osnovnom i srednjem obrazovanju,

Član 42.5 do povratka raseljenjih pri finansiranju moraju biti uvažene posledice raseljenja kod mreža škola, veličine odeljenja, norme časova i ukupnog broja zaposlenih.

Član 42 direktora škola za srpsku zajednicu biraju školsk odbori na osnovu javnih konkursa. Pri pribavljenom mišljenju nastavnika veća, školski odbor ima trečinu članova iz lokalne samouprave trećinu iz sastava nastavnog veća i trećinu iz reda saveta roditelja,

To su amandmani koji tičeu zakona o osnovnom i srednjem obrazovanju, a što se tiče Zakona o višem i visokom obrazovanju tu nije bilo naročitih primedbi stoji zahtev jedna od zajednica koja je prihvaćena od komisiji da se utvrdi kvoto zajednice, naročito manjinjski za upis na više i visoke škole. Jedna primedba u deo poglavlja regulisana opšte odredbe u članu 1, 1 pod značajne drugog izraza u mesto reči državna vlast da se stave privremena institucija samouprave . Insistiramo da se usaglase tekstovi u Nacrtu zakona na tri jezika na albanskom srpskom i engleskom to je ono pitanje kod člana 10.7 gde se pominje Univerzitet u severnom Kosovu i hoću da ukažem na jednu odredbu iz Ustavnog okvira, odredba iz poglavlja 1 gde je regulisano pitanje Skupštine. Znači u

tački 9,1. 49 rečeno je da se sednica Skupštine i njenih odbora vode i na albanskom i srpsku jeziku a dalje kaže da se sva zvanična dokumenta Skukpštine štampaju na albanskom i srpskom jeziku, te mislim da nema zaista mesta za priču da smo juče raspravljali samo o zakonskom projektu koji je dat na albanskom jeziku, nego smo barem mi iz koalicije Povratak imali u vidu zakonski projekat koji je bio dat na srpskom jeziku. Hvala,

NEXHAT DACI

Si duket kurqysh nuk po mundemi me i harmonizu. Unë thash që në rend dite është aprovimi i ligjit mbi shkollimin e lartë, ndërsa kryesuesi i komuniteteve filloj me ligjin mbi shkollimin fillor dhe të mesëm, nuk prishë punë ne këtë,

Sipas rregullave duhet të gjitha amandamentet e propozuara teoritikisht një që duhet t'i përkrahë e një që ka duhet të kundërshtojë. Unë mendoj që aq shumë jam i përkrahur dhe unë mendoj që duhet të me kundërshtu këto gjatë debateve sa që nuk po e shof, por po e them se unë do t'i kem si dokument bazë propozim ligjin e Qeverisë së Kosovës, Mendimet e Komisionit për edukim, shkencë dhe teknologji dhe pastaj radhë mendimet e propozimet edhe individuale grupore që janë bërë dhe përfundimisht duhet t'i nënshtrohemi vendosjes demokratike, për edhe kundër aprovimit, e në qoftëse dikush don me diskutu, jo debate por diskutime.

OLIVER IVANOVIĆ KP

Nas interesuje samo da nam pojasnite sada, šta u ovoj situaciji glasamo o osnovnoj verziji koju je ministarstvo ponudilo. Nas interesuje najviše tačka 10.7. Da se razumemo, ta će tačka odlučiti hoćemo li se pridružiti i glasati za ili ćemo glasati protiv. Znači, da li glasamo za osnovnu verziju koja je ponuđena i o kojoj smo raspravljali juče i danas, posebno se odnosi na tačku 10.7 da li 10.7 ostanje izvorna verzija ona na srpskom i na engleskom ili se ona na ovaj slučaj menja po predlogu na Ministarstva jer mi smo duženi da govorimo o predlogu ministvarstva ali ja svatam da i

ovaj predlog koji ministvarsto danas nudi zapravo amandman u izvesnom smislu on je danas predložio ako se ne varam da se razgovara samo o albanskoj verziji predmet o ovoga predloga zakona, samo jedno pojašnjenje pre nego što pređemo na glasanje.

NAIM MALOKU

I nderuari z. Kryetar, i nderuar ministër të nderuar deputetë,

Para se të votoj për një ligj shumë të rëndësishëm për Kosovën unë dua të di se për çfarë ligji votoj, a votoj për ligjin e arsimit për tërë territorin e Kosovës apo votoj për ligjin vetëm për shqiptarët, por kjo nuk është sqaruar. Nga ekspozea e z. ministër jam shumë i shtetësuar se del fakti se Ministria e Arismit të Kosovës nuk ka ingirenca në tërë territorin e Kosovës, që vjen ndesh me Kornizën Kushtetuese, me preambulën 1 dhe 2 të Kornizës Kushtetuese dhe me kompetencat e këtij Parlamenti. Kjo është shumë serioze dhe kërkon debat. Unë kërkoj që seriozisht t'i çasemi ingirencave të Qeverisë së Kosovës në territorin e Kosovës. Duhet një seancë e veçantë këtu nëse qitet kjo seancë për votim ky ligj. Ne pastaj do të votojmë për dy ligje për ligjin shqip dhe atë serbisht, këto janë gjëra të cilat duhet të sçarohen, nëse e marr fjalën ju lutem z kryetar dhe ministër ju lutem që një çasje në të ardhmen të ketë edhe aftësimi i invalidëve, pra programet e veçanta për aftësimin e tyre dhe kyçje në punë. Ju lutem që të bashkëpunoni me Ministrinë për Punë dhe Çështje Sociale në mënyrë që invalidët që janë një numër i madh i tyre, qoftë pjesëtarët e UÇK-së ose të rinjtë që janë invalidë nga pasojat e zhvillimeve të aktiviteteve luftarake në rajon ata të kyqen në shoqëri nëpërmes angazhimit të tyre në punë. Ju lutem këtë ta merrni si sygjerim që seriozisht t'i qasemi këtij problemi së bashku me Ministrinë për Çështje Sociale dhe Punë që ajo kategori e shoqërisë të mos mbetet vetëm në moshën e shoqërisë dhe ata të kyqen në proçesin e punës. Edhe një lutje, ju lutem që sa më shpejtë të gjendet me Ministrinë e Financave mundësia e ndërhyrjes në përmirësimin e kushteve materiale të mësimëdhënësve që viti shkollor të fillojë si duhet. Ju lutem, dyshimin të cilin unë e shpreha në lidhje me votimin tim, të merrni seriozisht se duhet të dimë se çfarë ligjesh po votojmë.

BERAT LUZHA

Të ndëruar deputetë,

Unë mendoj se para se të votojmë duhet të kërkojmë që të harmonizohen tri verzionet e teksteve ai anglisht dhe ai serbisht, për shkak se unë dyshoj se duke votuar versionin shqip, ne do ta votojë versionin anglisht dhe në këtë mënyrë do t'i japim vizë këtij projektligji, i cili parasheh edhe formimin e universitetit të Kosovës veriore. Unë jam shumë i pakënaqur me jo transparencën e ministrit i cili nuk ka paralajmëruar për një rezik të tillë dhe sot e kësaj dite nuk tregon se kush është autori i ndryshimit të teksteve në të tri verzionet.

ARSIM BAJRAMI

Kryesisht do të ngeli në dy çështje, e para është parimore, e dyta procedurale, meqenëse bëhet fjalë për një ligj që është në kompetencë të plotë të organeve të Kosovës bëjnë pjesë në të ashtuquajtura kompetencat bartë në organet e Kosovës, mendoj se është e palejueshme që nga Qeveria të na procedohen edhe tri verzione të ndryshme me ndryshime. Mendoj se ky ligj është plotësisht ligj i organeve të Kosovës që bënë pjesë në përgjegjësitë e Kosovës dhe tekstet duhet të ishin të harmonizuara në momentin kur janë proceduar në Parlament. Mendoj se është një praktikë që nuk duhet të lejojmë në të ardhmen se tekstet e njejta na vijnë në versionet e ndryshme, përndryshe dallimi është esencial. Unë kërkoj që ky Parlament vërtet sot ta sqaroj këtë fakt që në mënyrë që të mos kemi implikime, për shkak se bëhet fjalë për një fakt shumë esencialë mendoj që kjo është një çështje.

Çështja e dytë është çështja procedurale. Duhet të kemi të qartë se si është procedura e votimit të ligjeve. E kishim versionin e Ministrisë së Arsimit, kishim amendamentet e tri komisioneve, kishim edhe disa amendamente të prezentuara nga deputetët. Çdo deputet ka të drejtë të propozojë amendamente. Unë dje kam propozuar afër 30 amendamente, që janë amendamente zyrtare të Universitetit të Prishtinës dhe dua ta di procedurën se si do të procedohej sipas tyre. Dje edhe unë kamë shtruar çështjen a është leximi i parë apo

leximi i dytë. Shumica e deputetëve dje kanë diskutuar në parim, me shpresë se sot do të kenë mundësi që propozimet e veta konrete t'i paraqesin, t'i elaburojnë. Unë kisha propozuar që sot mos të ngutemi. Ne po fillojmë praktikën e nxjerrjes së ligjeve e këto dy ligje janë shumë të rëndësishme. Ligji që nuk do të reflektojë interesat partiake. Duhet të bëjnë ligje në interes të Kosovës për shkak se pretendojnë të krijojnë një arsim të avansuar në Kosovë do të jenë ligje të vazhdueshme. Ne nuk do të mundemi çdo muaj çdo vjet me ndrru ligje. Këto ligje për tri vjet do të jenë bazë për reformimit të Kosovës, andaj nëse humbim një orë ose 2 ma tepër nuk do të kemi humbje kohë për shkak se do të jemi të sigurtë që kemi marrë të gjitha shqetsimet dhe kemi bërë vërtetë ligjet e mira që do të jenë funksionale për arsimin e Kosovës.

RANDJEL NOJKIĆ

Gospodine predsedavajući, dame i gospodo,

Pa ja takođe opet izgleda da sam dežurni ovde oko procedure da li je ona dobra ili nije. Nažalost ja moram stvarno time i meni nije jasno kao i što prethodnom govorniku za ovom govornicom. Da li je ovo nastavak jučerašnje sednice ili je sednica nova, ako je nova trebali smo ponovo da u tvrdimo dnevni red. Vi ste samo nakratko rekli da je ovo završno razmatranje. Pretpostavljam da idemo na čitanje, na osvajanje posle svega ovoga na osvajanje zakona procedura govori nešto drugo. Čini mi se da pre glasanja mi moramo da imamo izmenjeni tekst i obavezno da se da izmenjeni tekst ono teksta koji će biti na glasanje. Ja taj tekst sada nemam jer nismo dobili i zapravo ne znam da li je uopšte moguće glasanje. Dalje mislim da tačka u ustavnim okvirima vezano za upotrebu jezika e vrlo jasno rečeno, i mislim da su ovde zvanični jezici i srpski i albanski. Mislim ako mi odvajamo sada zakone, pa glasamo za jednu verziju a za drugu verziju ne glasamo, ne znači ti to da li će sada svaka zajednica prihvatiti svoju verziju pa primenjivati tu svoju verziju ili će biti jednostavno jedna zajednica apsolutno diskriminisana i taj predlog uopšte neće ići na glasanje. Prema tome mnogo je nejasnoće. Ja bih vas molio da nam objasnite da li je procedura kojom se sada ide ka izglasavanju ovog zakona u redu ili nije, Hvala.

XHAVIT HALITI

Zoti kryetar, të nderuar kolegë,

Ne vërtetë kemi hy në një vështërsi jo vetëm procedurale, por edhe një vështërsi nga e cila mund të dalim vetëm së bashku. Mendoj për të miratu vetëm një ligj nuk mund të ketë as verzion shqip, as version serbisht as version anglisht. Një ligj mund të jetë vetëm një ligj i një vendi të caktuar edhe ai i përkthyer shqip, serbisht, anglisht, rusisht, kinisht vetëm një ligj mundet me qenë.

Nuk më shqetëson aspak pse minoriteti serb është i interesuar me u shkollu në gjuhën e vetë. Është e drejtë e tyre dhe duhet të kenë mundësi që të shkollohen në universitetin përkatës, lë të quhet ai qysh don. Por, mendoj që një universitet i kujdoqoftë duhet të jetë një universitet konform ligjeve të Kosovës dhe ligjeve që i miraton ky Parlament dhe konform dofarë propozimesh për t'u inkuadru në proceset mësimore të Serbisë, kuptohet duke mos me ia mohu askujt të drejtën që ta mësojë kulturën gjuhën e vetë. Prandaj, unë mendoj që për të miratu këtë ligj duhet të fillojmë një procedurë të re një mënyrë të re, të funksionimit të veprimit në Parlament të futemi në miratimin e këtij ligji nen për nen, përndryshe në qoftëse votojmë në bllok do të votojmë për ligjin anglisht, për ligjin shqip, serbisht dhe nuk do të na e pranoj kurkush, do të procedojmë me nënshkrimin e kryetarit deri te zoti Shtajner dhe do të na kthejë prapë në diskutim.Faleminderit

SANIJE ALIJAJ

Z. kryetar, zotëri deputetë,

Unë kam dalë të shprehë një brengosje si mund të merr vendim Kuvendi për aprovimin e një ligji për veprimtari shoqërore me të cilin Kosova ka mbijetuar dhe e ka trasu rrugën e vet të ndritur pa praninë e kryeministrit në këtë seancë plenare, njiherit edhe pa praninë e ministrave tjerë, çka mendojnë ata, a thu do të ketë ndonjë Ministri tjetër sukses nëse nuk do të ketë Ministria e Arsimit sukses? Çka mendon kryeministri a më është e dobishme t ë s hkoj t ë v izitohet n jë k omunë a m ë e d obishme ë shtë t ë marrë p jesë n ë

debatin edhe në amendamentet që bëjnë përpjekje ky Kuvend për të aprovuar me të vërtetë që do ta çojë përpara arsimin në Kosovë,

NEXHAT DACI

Edhe një herë , shkresën zyrtare që e kam unë si kryetar i Parlamentit ësht shkresa e kryemimnistrit, dhe zyra e kryeministrit në anglisht thotë, vetëm po e ceki fjalinë. Duke marrë parasysh projektligjin mbi arsimin e lartë 2002 të datës 13 qershor dhe projektligjin mbi arsimin fillor dhe të mesëm 2002 të datës 13 qershor aprovuar nga Qeveria e në mbledhjen e saj më 13 qershor 2002 përputhen me kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve për vetëqeverisëse të institucioneve të Kuvendit të Kosovës e nënshkruar nga Dr. Bajram Rexhepi, kryeministër i Kosovës edhe Lard Stamers ushtrues i detyrës së sekretarit të përhershëm të Qeverisë,
Atëherë mos të kemi konfuzione në këtë aspekt dhe pastaj do të bisedojmë,

FATMIR SEJDIU

I nderuar z. kryetar të nderuar deputetë,

Do të lidhesha pikërisht nga konstatimi i juaj që mos të ketë konfuzione, por konfuzioni është krijuar dhe është e rezikshme që në një debat që ka filluar ditën e djeshme dhe se sot prapë vazhdon me të veten, nuk kemi një variantë, e cila duhet të hedhim votën si duhet.
Unë do doja të polemizoja me disa çështje që i kemi dëgjuar deri tash, Mendoj që çasja themelore e këtij Kuvendi dhe institucioneve të përkohëshme vetëqeverisëse të Kosovës është nxjerrë një ligj do të jetë funksional në gjithë territorin e Kosovës, do të jetë një ligj i cili do të garantojë të drejtat dhe liritë njerëzore të gjithëve në kuptimin e arsimimit të plotë deri në nivelin universitar, do të jetë një ligj i cili do të hedhë jashtë fuqie gjith strukturën paralele në Kosovë.

Çështja e dytë është ajo e cila lidhet me aspektet procedurale që ushtruan disa herë. Mendoj se edhe Korniza Kushtetuese, po edhe rregullorja e punës janë të çarta. Janë dy shqyrtime eventualisht është e treta, mirëpo çka nënkupton kjo e treta, është varianti i një teksti të spastrum final, i cili duhet të miratohet. Çka nënkupton kjo, nënkukpton se pas shqyrtimit të parë dhe shqyrtimit të dytë të nevojshëm të jetë një tekst i harmonizuar, i cili prapë do të debatohet nen për nen, para nesh në mënyrë që tu heqim pikërisht ato konfuzione dhe ato dilema të cilat mund të na shkaktojë dilema më vonë.

Unë nuk e pranoj dhe kujtoj asnjë prej deputetëve që mendon esull asnjë tekst që duhet të vijë para Kuvendi nga Qeveria në këtë rast apo i propozuar në variantet tjera që ka verzione të ndryshme, Guha zyrtare e Kuvendit të Kosovës dihet ne besoj që edhe nga Kuvendi edhe nga Qeveria paralel besoj që edhe përfaqësuesit e Qeverisë do t'ia përcjellin, duhet të formojë një trup ashtu siç ka propozuar edhe Komisioni i buxhetit të njësisë së teksteve, nuk mund të vijë me variante. Unë se kamë ditur e se kam dëgjuar, pastaj do të kemi interpretime tjera, sepse do të ballafaqohemi me pushtetin e përfaqësuesit special, në këtë rast thotë se kjo ka qenë urdhëresa ime, shkrimi im apo akti administrativ që unë kam lëshuar. Është një fazë e më hershme, e kemi shkresën e cila vërtetë i ka nxjerrë këto debate. Prandaj, unë them se duhet të kemi kujdes. Për mua, personalisht si deputet i këtij Kuvendi më e mira është që të ndalet edhe Ministria në ballafaqim me argumentet apo me amendametet që janë shtruar diskutimet dhe të jetë një vërcion final bashkë me komisionet gjegjëse se sa të lanë variantet të cilat po i shoh se e kanë ekuivok, nuk mund të jetë i pranueshëm variant, po zëmë se teksti lëshohet, miratohet në parim nga ana e komisioneve të komuniteteve, por lihet diçka tjetër për të kuptuar se ne kemi çfaq moskënaqësinë tonë apo mospajtimin tonë. Sistemi i asimimit dhe edukimit të Kosovës duhet të jetë sistem unik, i cili mund të jetë i përputhshëm me standardet ndërkombëtare, nuk mund të jetë sistem i cili do t'iu nënshtrohet sistemeve të tjera të arsimimit dhe edukimit, ai do të jetë i përputhshëm që nënkupton bashkëpunimin edhe me vendet e rajonit edhe më gjerë dhe këtu një mundësi kanë edhe ata që janë në studim e sipër edhe që mbarojnë studimet të kenë mundësinë e inkorporimit në rrjedhat bashkohëse të sistemeve universitare apo sistemeve tjera të arsimit sikur që duhet të tentojë vendi ynë dhe secili shtet.

EDI SHUKRIU

Z. kryetar, Kryesi, delegatë të nderuar,

Nuk mendova ta marrë fjalën, duke menduar se kontributi ynë për këtë ligj tejet të rëndësishëm është dashur të jetë edhe në mëynrë konkrete me shkrime edhe mos të merret koha e çmuar e gjithë delegatëve.

Dita e djeshme më nxiti që dal sot në foltore, të them pikësëpari se e ndiej veten të nderaur para delegatëve të cilët bëjnë ligje dhe do të duhej ta miratonin një ligj tejet të rëndësishme dhe për një çështje tejet të rëndësishme për Kosovën dhe për ardhmërinë e Kosovës. Fillimisht dua të them, po flasim për ligjin si delegatë duhet të mendohemi edhe për rrugën si të arrihet deri te ligji, apo si u munduam të arrijmë deri te ligji, mënyra si u bë dje me tri tekste nuk mund të kalohet pa u pa përgjegjësia e atyre që e kanë bërë këtë. Mendoj se nuk është bërë rastësisht. Edhe dje si delegate e popullit të Kosovës e kam n die v eten t ejet t ë o fenduar. T huhet s e n uk d i, a po f ajtori ë shtë j etim s iç t honë. Besoj se nuk duhet të kalohet në këtë përbërjen tonë. Dëgjova edhe nga ministri i arsimit se nuk dihet e tjera e tjera, rastësisht më ra ose mjerisht sadoqë ne si delegatë duhet t'i kishim gjitha dokumetet, ashtu si në të tri gjuhët e njejta, çdo herë në boksin tim kam gjetur tri verzionet apo kryesisht verzionin shqip apo të gjitha dokumentet shqip apo anglisht shqip e anglisht dje me gjithë kërkesat e mia që ta kemë verzionin anglisht menzi u sigurua pas përfundimit të seancës, z. Kryetar për këte dikush mbanë përgjegjësinë. Kisha pasur dëshirë që gjërat e tilla mos të përsëriten. Në të ardhmen edhe përgjegjësia të ndahet, përgjegjëja për gjëra se nuk dimë jo, ju lutem në qoftëse ne jemi ata të cilët duhet të dëshmojë me gjithë strukturën e Parlamentit edhe atë teknikën e parlamentëve të gjithëve demokracinë, atëherë një prej kushteve themelore të demokracisë është transparenca.

Në këtë rast është dëshmuar se transparencë nuk ka, aq më tepër kur merren disa veprime të cilat mu në këtë zhvillim demokratik, dikush mund të thotë se ja ekziston autoriteti i të deleguarit special, i sekretarit gjeneral të Kombeve të Bashkuara po e

kuptojmë, dikush mund të thotë ekziston udhëzimi administrativ etj. Nuk kuptoj pse gjitha këto bëhen prapa shpines sonë. Aq më tepër nuk e kuptoj kur e shoh në dokument se një i deleguar i mëparshëm e ka ndaluar këtë pastaj bëhet diskutimi që kjo të aprovohet para konstituimit apo para Parlamentit, do të thotë gjërat të bëhen pas, kuptoj mbase janë të nevojshme tjerë e tjerë, natyrisht që jam kundër strukturave paralele dhe veprimeve paralele, në kohën kur universiteti nuk po mjafton për 90% të shqiptarëve kur po mbyllen thuhet nuk po mbyllen do shkolla të larta, por megjithate ekzistojnë shkollat e larta që nuk kanë mundësi, do të thotë të hapin konkurse etj.

Ne tani e kemi, na doli para deputetëve, besoj që e ndieni veten keq si unë. Dje mora vesh për universitetin e Kosovës veriore. Nuk di që ka Kosovë veriore, kuptoj edhe vetë do të luftojë për arsimimin e çdo qytetari të Kosovës, çdo fëmije, çdo studenti. Nuk kuptoj pse universiteti, pse rektori gjithë strukturat e tjera, nuk e kuptoj nuk e di a kuptoni edhe ju, thuhet gjithë kjo bëhet nga buxheti i Kosovës, ndoshta dikush nuk guxon të thotë ate etj. Në pjesën e katërt të këtij dokumenti për universitetin e Kosovës veriore, në pjesën e katërt neni 4.1 thuhet nga buxheti i Kosovës, tani erdha edhe te një çështje tjetër, edhe vetë punojë në arsim, po e di kontributin e arsimit për gjitha gjeneratat, ne sot jemi këtu i dimë nevojat e reformat në të gjitha nivelet, po jam e vetëdijshme se me nivelin e finansimit të arsimit në këtë gjendje nuk mund të bëjnë reforma dhe avansimi jonë e tani nga buxheti jonë një pjesë e mjeteve shkon dikun tjetër. Shpresoj se edhe për gjërat tjera nuk shkon, ballafaqimet e tilla i kam kuptuar si udhëheqëse e Departamentit për Kulturë, kam shpresuar se pas zgjedhjeve nacionale në Kosovë gjërat do të jenë shumë transparente edhe lus deputetët të gjithë të jemi më aktiv, të mos lejojmë në të ardhmen veprimet e tilla. Ju falemnderit

NEXHAT DACI

Asnjë fjalë, asnjë bisedë, asnjë diskuktim, unë po e shohë disponimin shumë të madh për debate politike,për debate që duhet pronësisht ta ndërrojmë rrjedhën, prandaj po jap pauzë gjysëmorëshe, prandaj e ftoi Kryesinë në përbërje të plotë, udhëheqësit e grupeve parlamentarë, kryetarët e tri komisioneve që e kanë shqyrtu ligjin në zyrën time, ju lutem.

(pas pauzës vazhdon mbledhja)

Ju lutem po vazhdojmë,

Në takimin e përbashkët që e kishim në një përbërje shumë të zgjëruar, të Kryesisë me udhëheqës të grupeve parlamentare dhe me komisione përkatëse, jam i mendimit që gjatë debatit janë paraqitur njëansime, njëmendime rreth procedurës së mëtejshme. Dominon mendimi që duhet t'i japim kohë njëjavore në mënyrë që Komisioni për arsim shkencë dhe teknologji dhe dy komisionet që e shoqërojnë këtë komision bashkë me Qeverinë të bëjnë një tekst të përbashkët jo unikë në tri kolona. E para, të jetë versioni në gjuhën shqipe, kolona e dytë në gjuhën serbe e kolona e versionit të tretë në gjuhën angleze, të njejtin tekst aty ku ka amendamente në nenin e caktuar të figurojnë ato. Kjo do të paraqitet të marten në Kryesi. Kryesia do ta shqyrtojë dhe ishim të mendimit që të ejten e ardhshme në orën 9 për, shkak të vapës së mëdhe, dhe ju lutemi mos të lypni fjalë për asnjë debat më as politike as përmbajtësore, por do ta ndjekim në mënyrë të rregulltë procedurën e aprovimit nen pas nenit dhe në mënyrë demoraktike do të votohet dhe unë shpresoj që të enjten e ardhshme që Kosova do t'i ketë ligjet për arsimin superior, të mesëm, fillor, prandaj shihemi në javën e ardhshme. Ju falemnderit.